



**UNIVERSITETI I EJL  
ЈНЕ УНИБЕРЗИТЕТ  
SEE UNIVERSITY**

**Universiteti i Evropës Juglindore**

**STUDIME POSTDIPLOMIKE –CIKLI I DYTË**

**TEZA:**

**“ KONFLIKTI ADMINISTRATIV DHE GJYQËSIA ADMINISTRATIVE  
– RASTI: RMV “**

**Kandidati:**

**Muamed Bexheti**

**Mentori:**

**Prof.Dr. Zemri Elezi**

**UEJL,Tetovë**

**2022**

# **“ KONFLIKTI ADMINISTRATIV DHE GJYQËSIA ADMINISTRATIVE – RASTI: RMV ”**

## **Abstrakti**

### **HYRJA**

#### **KAPITULLI - I - KONFLIKTI ADMINISTRATIV**

1. Gjenezja e konfliktit administrativ
2. Kuptimi i konfliktin administrativ
- 2.1 Llojet e konflikteve administrative
  - Konfliktet administrative objektive dhe subjektive
  - Konfliktet mbi ligjshmërinë e akteve
  - Konflikti i juridiksionit të plotë

#### **KAPITULLI - II –AVANTAZHET DHE DISAVANTAZHET E GJYKATAVE ADMINISTRATIVE**

1. Shqyrtimi ligjor i akteve administrative nga gjykatat e pavarura
2. Avantazhet që ofron në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative Gjykata Administrative
3. Disavantazhet e krijimit të gjykatave administrative
4. Instalimi i gjyqësisë administrative
5. Mënyrat e instalimit organizativ të gjyqësisë administrative
6. Si u instalua gjyqësia administrative në vendet e Unionit European

#### **KAPITULLI - III – GJYQESIA ADMINISTRATIVE NE RMV**

1. Historiku i Gjyqësisë administrative në RMV, 1991-2006, 2006-2010 dhe 2010- e këndej
2. Organizimi i Gjykatës Administrative në RMV
3. Shkallëzimi i procedimit gjyqësor në gjyqësinë administrative në RMV
4. Zgjedhja dhe statusi i gjykatësve në Gjykatat administrative
5. Sfidat e GJA në RMV
6. Reformat në gjyqësinë administrative në RMV

## **KAPITULLI - IV**

### **Studimi empirik**

#### **I. Intervistat**

1. Intervistë: Me Avokatin e Popullit të RMV-së, z.Naser Ziberi
- 1.1 Raportet e punës dhe konstatimet e Avokatit të popullit të RMV me Gjykatën administrative dhe Gjykatën e lartë administrative, për vitin 2020, 2021 dhe deri më 31.05.2022
- 1.2 Konstatimet për gjyqësinë administrative – Raporti i punës për vitin 2020
- 1.3 Konstatimet për Gjyqësinë administrative – Raporti i punës për vitin 2021
2. Intervistë: Me gjykatësin e Gjykatës Supreme të RMV-së, Mr.Faik Arslani
3. Intervistë: Me gjykatësin e Gjykatës së Lartë administrative të RMV-së, Dr. Subhi Jakupi
4. Intervistë: Me Prof. Dr. sc. Jeton SHASIVARI - Profesor Ordinar në lëmin juridike: E drejta kushtetuese dhe Administrative, Universiteti i Evropës Jug-Lindore, Tetovë
5. Intervistë: Me Prof. Dr. sc. Blerton Sinani - Profesor inordinar në lëmin juridike: E drejta kushtetuese dhe Administrative, Universiteti i Evropës Jug-Lindore, Tetovë

#### **II. Përfundimi, konkluzat dhe rekomandimet**

### ***Deklarata***

*Unë Muamed Bexheti, deklaroj se teza është realizuar nga unë dhe se nuk është paraqitur më parë asnjë mbrojtje tjetër të ndonjë diplome apo kualifikimi profesional. Konfirmoj që punimi është imi dhe kudo që përfshihen pjesërisht kontributet e tjerëve, është bërë përpjekje për ta treguar këtë qartë nëpërmjet fusnotave dhe literatures.*

### ***Statement***

*I Muamed Bexheti, state that the thesis is done by me and that it is not shown anytime time before in any other defence thesis of another diploma or professional qualification. I confirm that this work is of mine and anywhere where others' contribution are included partially, it is done an effort so that this is mentioned in the literature and footnote part.*

### ***Deklaratë e lektorit***

*Unë, \_\_\_\_\_ deklaroj se e kam kryer lekturimin e punimit të masterit të Muamed Bexheti me titull “Konflikti administrativ dhe gjyqësia administrative, rasti-RMV”, në aspektin drejtshkrimor të gjuhës standarde shqipe dhe rregullat teknike të punës shkencore dhe akademike. Nëse ky punim në të ardhmen botohet në një revistë shkencore apo si botim i veçantë, duhet t’i bëhet lekturim më i plotë.*

*Shkup, më . .2022.*

*Lektoroi:*

\_\_\_\_\_  
Email adresa:

### ***Statement of the lecturer***

*I \_\_\_\_\_ state that I have done the lecturing part of the master thesis of Muamed Bexheti on the topic “ Administrative conflict and the administrative judiciary, the case of RNM”, on the orthographic aspect of the standart albanian language and the technical rules of the scientific and academic rules of work. In case this scientific work is published in the future or as a special publishment, a more complete lecturing should be done.*

*Skopje , 2022*

*Lecturer:*

## **Abstrakti**

*Mbrojtja administrative gjyqësore nuk do të realizonte esencën e saj, poqëse ajo nuk do të realizohej në mënyrë efikase dhe efektive. Efikasitetin e parashofim nëpërmjet obligueshmërisë së aktgjykimeve gjyqësore ndaj paditësit, të paditurit, palëve të interesuara dhe gjykatës. Ajo do të thotë se organet publike janë të obliguara të veprojnë sipas udhëzimeve të cekura në aktgjykime dhe të njëjtat t'i kryejnë në afatin e paraparë ligjor, respektivisht në pajtueshmëri me Ligjin për konfliktet administrative, e që është 30 ditë. Por, në punën praktike të Gjykatës administrative jo rrallëherë ndodh që organet publike mos e zbatojnë aktgjykimin që shihet në Raportet vjetore të punës së Gjykatës administrative. Si rrjedhojë, lëndë e analizimit në punimë do të jenë dispozitat juridike që e rregullojnë këtë problematikë. Poashtu theks i veçantë do t'ju kushtohet edhe Rekomandimeve të Komitetit të Ministrave, i cili i përkushtohet sidomos zbatueshmërisë së vendimeve administrative dhe gjyqësore nga lëmia e së drejtës administrative. Theks i veçantë në këtë hulumtim ka të bëjë me çështjet në vijim, edhe atë: kur një aktgjykim bëhet i ekzekutueshëm; kush janë të drejtat dhe obligimet e palëve; në bazë të cilave dispozita bëhet ekzekutimi dhe cilat janë sanksionet për mosekzekutimin e aktgjykimeve. Njëkohësisht në punimë analizohet edhe eksperiencia e deritanishme e punës së Gjykatës administrative në aspektin e zbatimit të aktgjykimeve, e tëra me qëllim që të zbulohen anomalitë e rregullimit të deritanishëm të kësaj çështjeje, të cilat parasëgjithash u tejkaluan me aplikimin e nenit 53 të Ligjit për konfliktet administrative të vitit 2006. Njëri nga qëllimet e hulumtimit është edhe ndikimi në risitë të cilat parashifen me Ligjin për konfliktet administrative të viti 2019, të cilat kanë të bëjnë me mundësinë e shqiptimit të dënimit me të holla të personave të autorizuar, gjegjësisht përgjegjës në organet publike të cilët nuk do t'i zbatojnë në kohë aktgjykimet. Përsëri ngelet enigmë se a thua kjo dispozitë do të ndikojë në ngritjen e vetëdijes tek organet publike për rëndësinë dhe rolin e efikasitetit dhe efektivitetit të mbrojtjes juridike dhe respektimin e vendimeve gjyqësore. Për t'a realizuar qëllimin e parashtruar në punim do të bëjmë analiza nga intervistat me subjekte dhe persona kompetent dhe analizat e të dhënave statistikore të Gjykatës administrative dhe do t'i shfrytëzojmë dispozitat pozitive dhe metodat komparative dhe cilësore.*

**Fjalë kyqe:** konflikti administrativ, aktgjykime, ekzekutim, vendime gjyqësor.

## Hyrje

Aktualisht në teorinë moderne juridike, nuk është aspak kontestuese se gjykatësit duke vendosur për konfliktin administrativ, kanë një pavarësi të theksuar në zbatimin e së drejtës. Përkrah mendimeve të caktuara kontradiktore, numri më i madh i teoricientëve janë të një mendimi se gjykatat sillen sipas normave të cilat lindin në bazë të praktikës gjyqësore-administrative si dhe të cilat paraqesin norma ligjore sipas të cilave detyrimisht duhet vepruar. Është e nevojshme të theksohet se konflikti administrativ në vendin tonë krahas avansimit të tij ende nuk është mjaftueshëm i zhvilluar por ende janë prezente disa anomali dhe zbraztira, të cilat në praktik e vështirësojnë punën e gjykatave. Konflikti administrativ si institut juridik në nivel të Republikës së Maqedonisë Veriore, është i rregulluar me ligj të veçantë të vitit 2006, Ligjin për konfliktet administrative<sup>1</sup>.

Në këte konstalacion të marrëdhënieve, gjykatat administrative në RMV, Gjykata administrative dhe Gjykata e lartë administrative në realitet kanë rol shumë të rëndësishëm dhe në mënyrë aktive janë pjesëmarrëse në formësimin e sistemit juridik të gjyqësisë administrative. Me fjalë tjera, praktika e gjyqësisë administrative në RMV, nuk konsiderohet si burim formal i së drejtës por e njëjta ka rol dhe rëndësi shumë të madhe në konfliktin administrativ, si formë themelore në mbrojtjen e qytetarëve në njëanshmërinë e organeve të shtetit.

E drejta për të kontrolluar ligjshmërinë e një akti administrativ, duhet të jetë gjërësisht e hapur, në mënyrë që personat, të cilët pretendojnë se u janë prekur apo cënuar të drejtat e tyre të njohura me ligj dhe aktet tjera të cilat janë në fuqi, kanë interes të kundërshtojnë aktin e administratës publike, t'u jepet mundësia të rivendosin të drejtat e cënuara. Principet dhe postulatet e shtetit të së drejtës plotësohen në atë moment kur nga ana e shtetit do të zbatohet kontroll gjyqësorë mbi aktet e administratës<sup>2</sup>. Ky kontroll detyrimisht duhet të zbatohet na gjykata të pavaruara dhe specifike të shtetit, ngase pjesa më e madhe e veprimtarisë administrative në fakt është juridike dhe nëse nuk është juridikisht e lidhur dhe e kontrolluar, hapen mundësi të mëdha për shkelje masovike të parimit të ligjshmërisë, me çka fillojnë të lëkunden themelet dhe postulatet e një shteti juridik dhe demokratik.

<sup>1</sup> Ligji për konfliktet administrative, (Gazeta zyrtare e RM, nr.62/2006, 150/210)

<sup>2</sup> Давитковски, Б., Павловска-Данева, А. (2006). Новата управно судска контрола над управата во РМ, Зборник на трудови на Правниот факултет, Скопје, 156-157

Në punim, analizohet gjyqësia administrative, me theks të veçantë në Republikën e Maqedonisë Veriore, si është funksioni i tij në sistemin juridiko-gjyqësorë në RMV, konfliktet administrative të treguara përmes analizave të veçanta juridike. Kujdes i veçantë në punim u përkushtohet të dhënave për funksionimin e gjykatës, të marra nga raportet zyrtare, në bazë të Ligjit për qasje të lirë deri te informacionet me karakter publik dhe kushteve ligjore sipas së cilave qytetarët dhe personat juridik mund të inicojnë konflikt administrativ duke përfshirë edhe mënyrën të cilën Gjykata administrative vendos sipas lëndëve të pranuar.

Arsyeshmëria profesionale e temës së punimit del nga fakti se intença esenciale e këtij punimi do të paraqes një llojë manuali për gjyqësinë administrative me të vetmin qëllim të mundësoj njohje më të mirë për funksionimin e bazës juridike. Arsyeshmëria shkencore e punimit del nga fakti se ky punim paraqet përpjekjen për analizë më të thellë dhe hulumtimin për specifikat e procedurës administrative në kompetencë të gjykatës administrative, i cili në esence nuk merret në mënyrë efikase me numrin e lëndëve.

Kjo çështje parashtron nevojën e themelimit të gjykatës administrative dhe aplikimit të reformave të vazhdueshme të mbështetura në praktikat evropiane, për krijimin e një sistemi gjyqësor administrativ të bazuar në parimet thelbësore për krijimin e një gjyqësie administrative, kredibile, efikase, efektive dhe eficiente duke u bazuar në parimet esenciale të Hapsirës Evropiane Administrative.



## KAPITULLI - I :

### I. KONFLIKTI ADMINISTRATIV

#### 1. Gjenezja e konfliktit administrativ

Historikisht , gjenezja e konfliktit administrativ si formë e kontrollit gjyqësorë ndaj ligjshmërisë së akteve administrative është i kahmotshëm, por parakushtet reale për realizimin dhe aplikimin e tij janë krijuar dhe janë të lidhura ngushtë me paraqitjen e shtetit të së drejtës.

Si parim esencial dhe i rrëndësishëm i shtetit të së drejtës ne mes tjerash është edhe vënia e administratës nën juridiksionin e rendit juridik, që do të thotë se në shtetin e së drejtës vlenë principi ligjshmërisë në punën e administratës ,gjegjesisht ligjshmëria mbi aktet dhe veprimtarinë e sajë.

Principi i shtetit të së drejtës pa prezencën e kontrollit gjyqësorë mbi ligjshmërinë e akteve administrative, është i pamjaftueshëm që dotë thotë se kontrolli gjyqësorë e kompletone funksionimin dhe kredibilitetin e shtetit të së drejtës ngase veprimtaria administrative është në shërbim të shtetit dhe në masë të madhe është e lidhur me sistemin juridik të shtetit.

Vlera esenciale të shtetit të së drejtës janë edhe liritë dhe të drejtat e qytetarëve të përcaktuar dhe të garantuara me norma juridike gjegjesisht me akte juridike, duke filluar nga akti më i lartë Kushtetuta dhe ligjet e deri te aktet konkrete administrative me të cilat qytetarët i realizojnë te drejtat dhe liritë e tyre si dhe përmbushin obligimet në marrëdhëniet në mes vedi dhe me shtetin. E gjithë kjo realizohet për mes administratës dhe veprimtarisë administrative.

Pra, administrata është ura lidhëse ne mes shtetit, përkatësisht shtetit juridik dhe qytetarëve. Në këte konstalacion shpeshëhere ndodhin pakënaqësi dhe dyshime në punën e administratës si veprimtari shërbyese ndaj qytetarëve dhe zbatimit të së drejtës dhe këtu na imponohet nevoja e mbikqyrjes dhe kontrollit të punës se organeve dhe akteve të administratës.

Dyshimi dhe pakënaqësia ndaj administratës dhe kontrolli ndaj akteve administrative për të zgjidhë dyshimet dhe pakënaqësinë, na sjellë deri te konflikti administrativ.

## 2.1 Kuptimi i konfliktit administrativ

Mbrojtjen më të plotë të ligjshmërisë së akteve administrative mund ta ofrojë vetëm një kontroll i mirëfilltë gjyqësor. Gjykata është në gjendje të vlerësojë drejtë ligjshmërinë e ushtrimit të veprimtarisë administrative si dhe të vërej rastet se kur cenohet ose jo norma ligjore. Mbrojtja gjyqësore nuk zbeh kontrollin administrativ, por ndihmon në rivendosjen e ligjit te cenuar në ato raste kur vetë kontrolli administrativ nuk ka arritur të garantojë në menyrë të mjaftueshme dhe efektive ligjshmërinë e akteve administrative. Është pikërisht kontrolli gjyqësor i cili siguron mbrojtjen e ligjshmërisë në funksionimin e administratës publike dhe që përben njëkohësisht garanci kushtetuese-ligjore për shtetasit, për mbrojtjen e të drejtave të tyre nëpërmjet një gjykimi-vlerësimi të drejtë publik, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj<sup>3</sup>.

Konflikti administrativ u mundëson palëve që të paraqesin qëndrimet e veta nëpërmjet një debati kontradiktor. Konflikti administrativ paraqitet ndërmjet individëve dhe organit të administratës publike, ose thënë ndryshe, ndërmjet subjekteve që nxjerrin akte administrative të cilat me atë rast manifestojnë pushtetin edhe të atyre subjekteve që ndodhën në pozitë të nënshtruar në marrëdhënien juridike administrative. Prandaj, gjykata në konfliktin administrativ, në mënyrë autoritare objektivisht dhe profesionalisht shqyrton çështjen e kontestuar administrative.<sup>4</sup>

Me ane te konfliktit administrativ realizohen dy qëllime themelore të lidhura reciprokisht:

- Në njëren anë, konflikti administrativ ka për qëllim realizimin dhe forcimin e parimit të ligjshmërisë në punën e administratës (*qëllimi objektiv*). Forcimi i ligjshmërisë në punën e administratës, përkatësisht me evitimin e paligjshmërisë në punën e administratës, që të përmirsohet puna e saj.
- Në anën tjetër, konflikti administrative ka për qëllim realizimin sa më të plotë të mbrojtjes së të drejtave **subjektive** të qytetarëve dhe personave juridik të

<sup>3</sup> Н. Гризо, С. Гелевски, Б. Давитковски, А. Павловска-Данева, „Административно право“, Скопје, 2008, стр. 244;

<sup>4</sup> Esat Stavileci: Hyrje në shkencat Administrative, faqe 119, Prishtinë 1997

përcaktuar me ligj, nga cenimet eventuale që mund t'u bëhen me rastin e nxjerrjes së akteve administrative përfundimtare<sup>5</sup>.

Konfliktet administrative zakonisht lindin nga marrëdhëniet juridike administrative në rastin kur me aktin administrativ përfundimtar të organit shtetëror ose të organizatës e cila ushtron autorizime publike, është cenuar ligji në dëm të individit apo të personit juridik, përkatësisht në favor të individit ose të personit të caktuar juridik. Konflikti administrativ është konflikt që lind ndërmjet individit apo personit juridik nga njëra anë dhe organit shtetëror nga ana tjetër, dhe i cili zhvillohet tek gjykata kompetente.

Të drejtën për të filluar konfliktin administrativ e ka personi fizik ose personi juridik në qoftë se konsideron se me aktin administrativ i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes direkt personal i bazuar në ligj. Konfliktin administrativ mund ta fillojë dhe Avokati i popullit, nëse me aktin administrativ është cenuar ligji në dëm të bashkësisë shoqërore, përkatësisht të institucionit të cilin e mbrojnë ai në baze të ligjit<sup>6</sup>.

## **2.2 Llojet e konflikteve administrative**

Në praktikën e të Drejtës administrative dhe teorinë administrative duke u bazuar në kritere të ndryshëm bën klasifikimin e llojeve të konflikteve administrative. Sipas këtyre kritereve, njihen disa lloje ndarjesh të konflikteve administrative por më të theksuarat janë:

1. Konfliktet administrative objektive dhe subjektive,
2. Konfliktet mbi ligjshmërinë e aktit administrativ dhe konfliktet e juridiksionit të plotë<sup>7</sup>
3. Konfliktet paraprake dhe plotësuese

### **2.2.1. Konfliktet administrative subjektive dhe objektive**

Ndarja e konflikteve administrative në konflikte administrative objektive dhe subjektive, bëhet në bazë të dy kriteriumeve, edhe atë:

---

<sup>5</sup> С. Гелевски, Управно процесно право, Скопје, 2003, стр.260;

<sup>6</sup> Ligji për Ombudsmanin ( "Gz.zyrtare e RM"nr.07-4502/1 datë 10.9.2003)

<sup>7</sup> Simeon Gelevski, Управно процесно право,1997 fq.257.

- kriteri i parë, ka të bëjë me natyrën gjegjësishtë llojin e aktit administrative i cili është lëndë e konfliktit administrative;
- kriteri i dytë, ka të bëjë me qëllimin e konfliktit administrative;

Sipas kriteriumit të parë, pra llojit të aktit administrativ:

Konflikte administrative objective janë ato konflikte administrative të cilët mund të iniciohen kundër akteve të përgjithëshme administrative respektivishtë kundër akteve normative administrative.

Konflikte administrativ subjektive janë ato konflikte administrative të cilët iniciohen kundër akteve konkrete – individuale administrative.

Sipas kriteriumit të dytë, pra qëllimit të konfliktit administrativ:

Konflikt objektiv administrativ ekziston atëherë kur qëllimi i konfliktit administrativ është mbrojtja e situatës administrative.

Konflikt subjektiv administrativ ekziston atëherë kur qëllimi i konfliktit administrativ është mbrojtja e situatës subjektive administrative.

Nëse nisemi nga kriteriumi i parë, në shtetin tonë nuk ekziston konflikt administrativ objektiv. Në RMV aktet e përgjithshme administrative (dispozitat administrative) janë lëndë e kontrollit të Gjykatës kushtetuese dhe për to nuk mundet te udhëhiqet konflikt administrativ.

Nëse nisemi sipas kriteriumit të dytë, në shtetin tonë ekziston konflikti administrativ subjektiv. Meqenëse, për konfliktin administrativ objektiv në praktikë mund të bëhet fjalë, poqëse si paditës paraqitet organi i cili mbron interesin e përgjithshëm publik. Në disa shtete, psh. Sërbi, në atë drejtim, konflikt administrativ mund të iniciojë edhe prokurori publik <sup>8</sup>. Atëherë mund të thuhet se konflikti administrativ është objektiv sepse prokurori publik nuk ka qëllimin e mbrojtjes së interesit individual ose personit juridik, por interesin e zgjeruar publik.

Tek ne, shiquar në mënyrë gjenerale, si paditës mund të paraqiten personat fizik dhe juridik, të drejtat dhe interesat e tyre janë cenuar me akte konkrete administrative, gjegjësisht iniciojnë konflikt administrativ, fillimisht për mbrojtjen e interesit të tyre. Gjithësesi edhe ndaj këtij konstatimi ka përjashtime.

---

<sup>8</sup> Закон о управним споровима, Службени гласник Републике Србије бр. 111/2009.

## **2.2.2. Konflikti mbi ligjshmërinë e akteve**

Në praktikën e përgjithshme administrative ndodhë që në disa raste të ketë konflikte mbi ligjshmërinë e ndonjë akti administrativ. Këtu është fjala për atë konflikt kur gjykata vendos të shqyrtojë vetëm çështjen e ligjshmërisë së aktit administrativ të kundërshtuar. Në konfliktin mbi ligjshmërinë e aktit gjykata vlerëson nëse me aktin administrativ e kundërshtuar është cenuar ligji në kuptimin material ose formal. Në këtë konflikt, gjykata nuk merret me vendosjen e pasojave juridike të aktit, por vetëm me ligjshmërinë e tij. Tek konfliktet e tilla, vendimi gjyqësor nuk ka efekte të drejtëpërdrejta juridike por ekzekutimi i tij kalon në kompetencën e atij organi, akti i të cilit është anuluar. Qëllimi i konfliktit mbi ligjshmërinë e aktit administrativ është shfuqizimi i atij akti, nëse vërtetohet se është i paligjshëm. Prandaj, ky konflikt quhet edhe konflikt i kufizuar administrativ. Te ky konflikt, në rradhë të parë mënjanohet paligjshmëria të cilën e ka prodhuar akti administrativ.

Ligji jonë për konfliktet administrative i vitit 2019, parimisht e parasheh konfliktin e ligjshmërisë si përjashtim e jo si rregull, që do të thotë se në sistemin tonë u fut risi në konfliktet administrative për shkak se Ligji paraprak për konfliktet administrative i vitit 2006, përmbante dispozita të kundërta ngase konflikti i juridiksionit të plotë ishte përjashtim ndërsa konflikti i ligjshmërisë rregull. Ashtu që, sipas Ligjit për konfliktet administrative të vitit 2019, është paraparë se gjykata çdoherë do të vendos me juridiksion të plotë (në mënyrë meritore) përveç nëse:

- Organi i paditur ka vendos sipas bindjes së lirë (diskrecionale) ose
- Natyra e punës administrative nuk lejon zgjidhje të juridiksionit të plotë gjegjësisht gjykata nuk mundet tërësisht t'i konstatoj faktet për çështjet esenciale dhe ekziston nevoja në procedurën administrative për t'u konstatuar gjengja e vërtetë faktike.

## **2.2.3. Konflikti i juridiksionit të plotë**

Bazuar në shumëllojshmërinë e akteve administrative në shumicën e sistemeve juridike, në disa shtete, në praktikë ndodhë që të bëhen edhe cenime të së drejtës subjektive dhe objektive. Te ky konflikt synohet zgjidhja që ka për qëllim kryesisht mbrojtjen e të drejtave subjektive dhe objektive. Në këtë rast, duhet theksuar se konfliktet e juridiksionit të plotë janë të shumëllojshme në sistemet juridike pozitive të

disa vendeve. Ne konfliktin e juridiksionit te plote vetë gjykata e vendos marrëdhënien kontestuese. Gjithashtu, gjykata mund te vendos sipas vleresimit te saj, jo vetem ligjshmerine por edhe oportunitetin e aktit administrativ te kundërshtuar.<sup>9</sup>

Ne konfliktet e juridiksionit te plote vendimet gjyqesore jane me te shumta se ne konfliktet mbi ligjshmerine e akteve administrative. Kjo ndodh per shkak se ne konflikte te tilla, gjykata nuk kufizohet vetem ne anulimin e aktit administrativ, por e zgjidh vete përfundimisht ceshtjen konkrete administrative.

Në legjislacionin e Maqedonisë gjegjësishtë sipas Ligjit për konfliktet administrative të vitit 2019, konflikti i juridiksionit të plotë bëhet rregull. Është theksuar se gjykata do të vendos në konflikt të ligjshmërisë vetëm në dy raste e cekura më lartë.

#### **2.2.4 Konfliktet paraprake dhe plotësuese**

Dallimi i konflikteve administrative në paraprake dhe në plotësuese, bëhet në bazë të kriteriumit se a i ka paraprijë konfliktit administrativë ose nuk i ka paraprijë, zgjidhja në procedurë administrative.

Konflikt administrativë paraprak, ekzistonë atëherë kur gjyqi vendos për konfliktin administrativë, ndërsa për atë lëndë ende nuk është sjellur asnjë akt administrativë në procedurën administrative, (psh. Gjatë heshtjes së administratës, kur udhëhiqet konflikt administrativë mu për atë që ska akte administrativë gjegjësisht kur supoyohet se është sjellë akt administrativë negativë).

Konflikt administrativë plotësues është ai konflikt administrativë që gjyqi e zgjidhë vetëm pasi është sjellë akte administrativë. (aktvendim) për lëndën administrative në procedurë administrative.

---

<sup>9</sup> Esat Stavileci: Hyrje në shkencat Administrative, faqe 127, Prishtinë 1997

## **KAPITULLI - II :**

### **I. AVANTAZHET DHE DISAVANTAZHET E GJYKATAVE ADMINISTRATIVE**

#### **1. Shqyrtimi ligjor i akteve administrative nga Gjykatat e pavarura**

Për të realizuar këtë punim u bë një krahasim midis mënyrës aktuale të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve administrative dhe mënyrës si do të zgjidheshin ato me anë të një organi të specializuar gjyqësor siç është Gjykata Administrative.

Shqyrtimi gjyqësor i veprimtarisë së organeve qeverisëse e ka origjinën e vet në filozofinë e shtetit që qeveriset dhe kufizohet nga ligji dhe bazohet tek parimi i epërsisë së ligjit. Në ditët e sotme, një shtet ligjor nuk mund të mendohet pa akses për të gjithë qytetarët tek një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar në bazë të ligjit dhe e aftë për të përmbushur kërkesat e zhvillimit të një gjykimi të drejtë<sup>10</sup>.

Qëllimi i shqyrtimit gjyqësor synon të përfshijë brenda juridiksionit të gjykatave administrative të gjitha paditë që lidhen me çështje administrative, dhe po ashtu të sigurojë një mbrojtje të gjerë ligjore ndaj të gjitha veprimeve administrative, pavarësisht formës së tyre si aktet individuale, normative ose kontrata administrative. Kontrolli si i “akteve të qeverisë” poashtu edhe i akteve të bazuara në diskrecion nga gjykata e apelit, si shkallë e parë, si dhe shmangia e konflikteve të kompetencës me gjykatat e zakonshme duke i transferuar paditë që paraqiten gabim në gjykatën kompetente, të cilës i përket çështja, janë një faktor shumë i rëndësishëm efektiviteti. Si i tillë, roli i shqyrtimit gjyqësor të veprimtarisë administrative është të mbrojë të drejtat e qytetarëve, por edhe të mbrojë interesin publik dhe rendin ligjor.<sup>11</sup>

Krahas këtij roli mbrojtës, kontrolli gjyqësor shihet si një mjet i rëndësishëm në rritjen e cilësisë së administrimit dhe qeverisjes së mirë. Zgjerimi i sektorit publik dhe rritja e kompleksitetit të vendim-marrjes administrative ka një ndikim të dyfishtë: nga njëra anë sjell forma të reja të aktivitetit administrativ dhe rritje të kërkesës për

---

<sup>10</sup> Prof.Ass.Dr.Fejzulla BERISHA-Doc.Dr.Jusuf ZEJNELI-E drejta administrative,Peje-2015

<sup>11</sup> Ivo Borkovic: Upravno Pravo, faqe 85, Zagreb 1997

fleksibilitet të administratës në shërbim të interesit publik dhe nga ana tjetër efektet e një zgjerimi të tillë mbi jetën individuale janë duke u rritur vazhdimisht.

## **2. Avantazhet që ofron në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative Gjykata Administrative**

Krijimi i gjykatës administrative, garanton që çështjet që i përkasin një fushe specifike të juridiksionit të gjykohen vetëm nga gjyqtarë të specializuar në këtë fushë. Duke u marrë shumë më shpesh me një gamë të kufizuar çështjesh, këta gjyqtarë mund të zhvillojnë dhe akumulojnë ekspertizën për të nxjerrë vendime me cilësi të lartë, që nuk do të kenë nevojë të ndryshohen nga shkallët më të larta, nëse kundër tyre bëhet ankim.

Ato mund t'i gjykojnë këto mosmarrëveshje më me efikasitet dhe shpejtësi, pasi atyre u duhet më pak kohë për të hetuar dhe reflektuar mbi elementët themelore të çështjes, ato zhvillojnë praktika specifike për menaxhimin e çështjeve dhe ata mund t'i drejtojnë dhe orientojnë palët në fazat e para të gjykimit. Autoriteti i gjyqtarëve të specializuar ka mundësi më shumë të pranohet nga palët dhe avokatët, sidomos nëse ata vetë janë të specializuar apo me eksperiencë në fushën përkatëse.

Transferimi i juridiksionit për sfera të caktuara tek gjykatat administrative mund të rrisë edhe efikasitetin e gjyqtarëve në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, pasi atyre nuk do t'u duhej të futeshin në sfera specifike ku dotë ishte e vështirë për të gjykuar si duhet raste kaq të rralla. Gjykatat administrative mund të kontribuojnë në njësimin e fushës përkatëse të juridiksionit.<sup>12</sup>

Gjyqtarët e specializuar do të ndikonin në pakësimin e mospërputhjeve në interpretimin dhe zbatimin e ligjit në fushën përkatëse, në saj të ekspertizës së tyre dhe numrit të paktë të gjyqtarëve. Një praktikë gjyqësore më e qëndrueshme bën të mundur një siguri ligjore, risjell besimin në shtetin ligjor dhe pakëson çështjet gjyqësore në të ardhmen.

Gjykatat administrative mund të jenë të dëshirueshme në lidhje me arritjen e një madhësie të përshtatshme për gjykatën. Studimet shkencore në vendet e ndryshme të Europës perëndimore nxorën përfundimin që efikasiteti optimal mund të arrihet nga gjykatat e një madhësie mesatare, ndërsa efikasiteti i gjykatave shumë të vogla si dhe i

---

<sup>12</sup> Prof.Ass.Dr. Fejzulla Berisha: E drejtë Administrative, faqe 166, Pejë 2013



gjykatave shumë të mëdha çënohet nga mangësi të ndryshme për shkak të madhësisë përkatëse të vogël ose të madhe. Kështu, në vend të pasjes së gjykatave të njësuara që janë shumë të mëdha, do të ishte më mirë të ngriheshin gjykata të veçanta, me kusht që edhe gjykatat administrative tëmund të kenë natyrisht një madhësi të mjaftueshme.

Një kombinim i sistemit gjerman (e drejta subjektive individuale) dhe francez (interes ligjor i kualifikuar), është çelësi për vendosjen e një koncepti të baraspeshuar për palën e interesuar. Ata që nuk preken në të drejtat e tyre subjektive ose interesat ligjore, nuk kanë të drejtën të ngrenë një padi administrative (legjitimiteti aktiv). Një institucion publik që padit një tjetër institucion publik nuk duhet të ketë të drejtën e padisë kur ato i përkasin të njëjtës varësi administrative.

Nëse një numër aplikantësh ndajnë të njëjtin interes, pranohen paditë e përbashkëta (ligji francez). Për rrjedhojë shqyrtimi ligjor i akteve administrative nga gjykata të pavarura do të synojë të krijojë mundësinë për kontrollin e të gjitha akteve për infrastrukturën që kalojnë përmes një procesi licencimi, po ashtu rrit gjithashtu transparencën e vendimeve administrative dhe luan një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit.

Krijimi i gjykatës administrative do të shërbejë si forcë stimuluese për modernizimin e administratës publike, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të administratës dhe rritjen e besimit të qytetarëve për institucionet publike. Ajo që është edhe më e rëndësishme është kontributi për të siguruar rendin kushtetues, veçanërisht për të mbrojtur të drejtat individuale përballë administratës publike.

### **3. Disavantazhet e krijimit së gjykatave administrative**

Themelimi i gjykatave administrative edhe pse është një faktor shumë i rëndësishëm në integrimin e Kosovës në Bashkimin Europian, duhet parë edhe në këndvështrimin e problematikave që mund të shkaktojë. Konkretisht shkalla e dëshirueshme e specializimit të gjyqtarëve për rezultatet e pritshme pozitive nuk kërkon domosdoshmërisht ngritjen e gjykatave administrative.

Pika vendimtare është ekzistimi i gjyqtarëve të specializuar për gjykimin e çështjeve përkatëse.

Themelimi i gjykatave administrative sjell deri në një çasjemë të profilizuar të trajtimit të çështjeve me natyrë administrative. Numri i çështjeve në fushën specifike

të juridiksionit zakonisht justifikon një numër më të pakët gjykatash nga sa janë në sistemin e zakonshëm gjyqësor.

Për pasojë, palët nga zonat e largëta do të duhet të përballojnë shpenzime më të larta dhe barrën e udhëtimeve më të gjata, gjë që mund t'u privojë atyre mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës në varësi të rrethanave konkrete. Gjithashtu nëse gjykata funksionon kryesisht si një gjykatë shëtitëse, efikasiteti administrativ do të binte dhe cilësia e veprimeve gjyqësore si dhe e vendimeve do të linte shumë për të dëshiruar. Ngritja e gjykatës administrative mund të shkaktojë mosmarrëveshje në lidhje me kompetencën ndërmjet gjykatave. Edhe nëse sfera ligjore e gjykatës administrative mund të ndahet nga pikëpamja teknike dhe lëndore nga sferat e tjera të ligjit, disa çështje me kompetencë të debatueshme nuk mund të evitohen. Këto mosmarrëveshje zakonisht shkaktojnë gjykime të ngadalta dhe shpenzime shtesë, dhe për pasojë pengojnë rritjen e pritshme të efikasitetit.

Krijimi i gjykatës administrative mund të dobësojë sistemin gjyqësor të zakonshëm. Në mënyrë të veçantë, efikasiteti i gjykatave të vogla të zakonshme mund të rrezikohet seriozisht nëse ngarkesa e tyre e çështjeve vazhdon të pakësohet. Për më tepër, mundësia e ndikimit reciprok pozitiv në dobi të gjykimit është shumë i ulët ndërmjet sistemeve gjyqësore të veçanta.

Sa më shumë gjykata të specializuara dhe autonome të krijohen, aq më shumë do të pakësohet juridiksioni i gjerë dhe i pasur i gjykatave të zakonshme, gjë që ka qenë një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e së drejtës. Ndarja e gjyqësorit në dy ose më shumë sisteme gjyqësore autonome ka mundësi që ta dobësojë pozitën e gjyqësorit brenda sistemit të balancës së pushteteve.<sup>13</sup>

Gjyqësori përbëhet vetëm nga një numër i vogël njerëzish, që duhet të mos bëjnë lobim për shkak të dinjitetit dhe postit të tyre.

Për pasojë, është gjithmonë rreziku i nënvlerësimit ose neglizhimit nga pushtetet e tjera, pavarësisht garancive kushtetuese për pavarësinë e tij. Nëse gjyqësori duhet të ndahet në pjesë, ky rrezik rritet, veçanërisht në lidhje me sistemet e gjykatave të specializuara. Në varësi të objektit të juridiksionit të specializuar, mund të jetë e vështirë të tërhiqen juristët e talentuar dhe të kualifikuar për gjykatat administrative, pasi juridiksioni i gjykatave të zakonshme siguron një zhvillim profesional më fleksibël dhe shërbimi në këto gjykata konsiderohet të japë shanse më të mira për karrierën dhe

---

<sup>13</sup> Dr. M. Dimitrijeviq: Uvod u pravu, faqe 225, Beograd 1986

pozitën e tyre në profesion. Nëse gjykatat administrative ngrihen për fusha shumë të ngushta të juridiksionit, neutraliteti i gjykatave mund të kompromentohet nga zhvillimi i marrëdhënieve të ngushta dhe njohjeve personale ndërmjet gjyqtarëve të specializuar dhe avokatëve të specializuar që normalisht mbulojnë këto gjykata.

#### 4. Instalimi i gjyqësisë administrative

##### 4.1. Pse duhet Gjykata Administrative?

Zhvillimi i shtetit të së drejtës, shtroi si nevojë imediate vendosjen e modelit të mbikëqyrjes administrative i cili, si paragjykohej, do të duhej të siguronte 'mbrojtje të gjerë juridike' në fushën e veprimtarisë administrative. Mendohej se ky mision do të mund të arrihej nëse bartës i mbikëqyrjes do të bëhej ndonjë trup i veçantë, pavarësia dhe autoriteti i të cilit do të siguronin që administrata në veprimtarinë e vet, të sillej në kuadër të normave juridike të së drejtës pozitive. Kërkesa për instalimin e gjyqësisë administrative nëpërmjet të gjykatave administrative u mbështet në një numër faktesh, ndër të cilët u theksua veçanërisht ai se gjyqësia administrative nëpërmjet gjykatave administrative paraqet një "formë e mënyrë shumë adekuate të mbrojtjes juridike, qoftë për shkak të profesionalitetit, qoftë për shkak të pavarësisë së tyre organizative".

Natyrshëm që mbi këtë dhe mbi një numër faktesh të tjera, Unioni European i dha një rëndësi të madhe gjyqësisë administrative përgjithësisht. Duket se dy momente janë me ndikim për rëndësinë që Unioni Eurio pian i jep gjykatave administrative.

- Së pari, shkakun se "pjesa më e madhe e së drejtës përgjithësisht gjindet në kompetencën e gjykatave administrative".
- Së dyti, për shkakun se vetë "Unioni European i jep rëndësi të veçantë mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së interesit publik".<sup>14</sup>

##### 4.2. Çfarë mundëson Gjykata Administrative?

Pa pretenduar që të bëjmë zbërthimin në hollësi, duhet theksuar disa prej mundësive të gjyqësisë administrative.

Së pari, 'ndikimin në rritje' të kontrollit gjyqësor të organeve publike që shihet me shumë interes në gjyqësinë administrative. Së dyti, ndërtimin edhe të një modeli të

<sup>14</sup> Esat Stavileci: Hyrje në shkencat Administrative, faqe 149, Prishtinë 1997

veçantë të kontrollit gjyqësor përgjithësisht, me qëllim parësor zgjerimin dhe forcimin e tij. Së treti, shtrirjen e ndikimit të parimit të ndarjes së pushteteve në vëllimin e kontrollit gjyqësor që shihet me shumë interes në proceset e demokratizimit të shoqërisë përgjithësisht. Së katërti, garantimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqtarëve, me qëllim parësor sigurimin dhe forcimin e parimit të ligjshmërisë në gjyqësinë administrative.

Nga më shumë përparësi të gjyqësisë administrative, do të përmendim vetëm disa prej tyre. Në rradhë të parë dhe, para së gjithash, duhet theksuar përparësinë e gjyqësisë administrative në 'demokratizimin e sistemit gjyqësor'. Një përparësi tjetër të gjyqësisë administrative përbën 'ndarja funksionale e saj nga sistemi i gjykatave të kompetencës së përgjithshme'. Përparësi më vete e gjyqësisë administrative është "rritja e besimit" të qytetarëve dhe të opinionit publik në punën e ligjshme të administratës. Më në fund, përparësi e gjyqësisë administrative është edhe mbrojtja e shtetasve nga "arbitrariteti i administratës". Natyrisht se do të mund të bëhej fjalë edhe për favore të tjera të gjyqësisë administrative. Pa i rradhitur sipas rëndësisë që kanë ose që mund të kenë, këto favore të gjyqësisë administrative duhet parë si mundësi më shumë për:

- Specializimin.
- Zgjidhjen më të plotë të konflikteve.
- Rolin krijues të gjykatave administrative në zhvillimin e të drejtës administrative.<sup>15</sup>

Gjykimet administrative nëpërmjet gjykatave administrative ka dhe një përparësi shumë të veçantë. Ajo shprehet në kompetencat e gjykatave administrative. Ç'është e vërteta, 'gjykatat administrative kanë kompetenca të plota, jo vetëm në zbatimin e ligjit, por edhe në vërtetimin e fakteve'. Praktika e gjykatave administrative është eiferente. Në disa prej vendeve me gjyqësi të zhvilluar administrative, kontrolli i gjykatave përqëndrohet në çështjen se a është nxjerrë vendimi i drejtë. Në disa vende të tjera, përqëndrimi i kontrollit të gjykatave administrative bëhet në të vërtetën materiale dhe në gjetjen e saj.

---

<sup>15</sup> Prof.Ass.Dr. Fejzulla Berisha: E drejtë Administrative, faqe 166, Pejë 2013

### 4.3. Cilat janë funksionet themelore të Gjykatave Administrative

Ndër funksionet e rëndësishme të gjyqësisë administrative, dy janë themelore: funksioni preventiv dhe funksioni represiv. Gjykatat administrative mbrojnë, në mënyrë preventive, të drejtat e individëve.<sup>16</sup> Ky lloj i mbrojtjes ‘pengon tejkalimin e autorizimeve të pushteteve ekzekutive dhe administrative’ në dëm të shtetasve. Ky funksion i gjyqësisë administrative njëkohësisht shprehet me ‘ndikimin në procedurën administrative’. Funksioni represiv i gjyqësisë administrative shprehet në aplikimin e sanksioneve, kur të paraqitet shkelja konkrete e rendit juridik

### 5. Mënyrat e instalimit organizativ të gjyqësisë administrative

Përvojat e para me gjyqësinë administrative, flasin se ajo organizativisht u instalua në tri mënyra, sa i përket bartësve të saj:

- Gjyqësia administrative nëpërmjet organeve të administratës.
- Gjyqësia administrative nëpërmjet gjykatave të rregullta.
- Gjyqësia administrative nëpërmjet gjykatave të veçanta administrative.

Këto tri mënyra të instalimit të gjyqësisë administrative instalojnë tri sisteme të zgjidhjes së konfliktit administrativ<sup>17</sup>.

Gjyqësia administrative nëpërmjet vetë organeve të administratës, në parim, nuk u pa si një mundësi e mirë, sepse duke e ushtruar këtë lloj të kontrollit ajo, në fakt, bëhej ‘gjyqtar në çështjen e vet’ dhe, për pasojë, pavarësia dhe objektiviteti viheshin në pyetje. Prandaj, mënyrat më të mira të instalimit organizativ të gjyqësisë administrative mbeten gjykatat e rregullta dhe gjykatat e veçanta administrative.

Mënyra e dytë e instalimit organizativ të gjyqësisë administrative, ajo nëpërmjet gjykatave të rregullta, në literaturë përgjithësisht është e njohur si sistem anglosakson, për shkak se lindja e saj lidhet me Britaninë e Madhe, por edhe me kolonitë e dikurshme të saj, veçanërisht në SHBA, edhe pse gjyqësia administrative nëpërmjet

<sup>16</sup> Dr. Sokol Sadushi: E drejta Administrative, faqe 254, Tiranë 2005

<sup>17</sup> Me gjerësisht: Esat Stavileci, Hyrje në shkencat administrative, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, Prishtinë, 1997; rekomandojmë: Debbasch, Ch., Contentieux administratifs, Paris, Dalloz, 1976

gjykatave të rregullta u përhap edhe në vendet skandinave, në rend të parë në Danimarkë dhe në Norvegji.

Komponenta nisëse e vendosjes së gjyqësisë administrative nëpërmjet gjykatave të rregullta ishte vetë e drejta britanike, e ‘frymëzuar nga ideja e së drejtës së përgjithshme’ (Common Law) që përfaqëson një ‘sistem të përbashkët(unik) të normave dhe parimeve juridike ndaj të cilave nuk vepron vetëm individi, por edhe pushteti publik<sup>18</sup>

Vlen të përmendet se sistemi britanik dhe ai amerikan nuk dallojnë në parim, po sikurse që vlen të theksohet se, përveç gjykatave të rregullta, mbrojtja juridike realizohet edhe nëpërmjet ‘administrative tribunale’ (gjykatave administrative) që, si rregull, themelohen ad hoc, si për shkollim, shëndetësi etj.

## **6. Si u instalua gjyqësia administrative në vendet e Unionit European**

Shqyrtimi i efektshëm gjyqësor i akteve administrative është një element thelbësor i sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në të njëjtën kohë është një instrument i domosdoshëm për përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë administrative dhe për të siguruar qeverisje të mirë. Për më tepër, është një kërkesë e një ekonomie në zhvillim, pasi siguria e tregtisë dhe investimeve ndërkombëtare kërkojnë organe publike vendimmarrëse që t’u nënshtrohen mjeteve të efektshme të mbrojtjes. Kjo ide themelore është pranuar nga të gjithë vendet europiane në këto dekadat e fundit, pavarësisht qëndrimeve të ndryshme në lidhje me krijimin dhe organizimin e juridiksionit administrativ.<sup>19</sup>

Edhe pse ky zhvillim bazohet në tradita të ndryshme dhe fusha e gjykimeve administrative ndryshon shumë në sistemet ligjore të shteteve të ndryshme, po ngrihet një kuadër përherë e më i qëndrueshëm i parimeve të përbashkëta. Këtu nuk përcaktohet se si duhet të organizohet shqyrtimi gjyqësor, por parashikon rregullat e përgjithshme që duhet të respektohen nga Shtetet Anëtare në organizimin e shqyrtimit gjyqësor të akteve administrative, dmth, ai reflekton gjendjen e tashme të “Standardeve Europiane” të cilat duhet të respektohen. Në kuadrin e këtij diskutimi, vlejné parimet e mëposhtme:

<sup>18</sup> Ivo Borkovic, Upravno pravo (E drejta administrative), ‘Informator’, Zagreb, 1997, faqe 449

<sup>19</sup> Jean – Marie Éochrling: Kontrolli Gjyqësor i autoriteteve Administrative në Europë

Shqyrtimi gjyqësor duhet të kryhet nga një gjykatë e ngritur me ligj pavarësia dhe paanësia e të cilës garantohej në kushtet e Rekomandimit Mbi Pavarësinë, Efikasitetin dhe Rolin e Gjyqtarëve.

Ky parim konfirmon që zgjidhja e një mosmarrëveshjeje administrative është çështje e një gjykate të ngritur me ligj, në pajtim me kërkesat e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithëse kjo e fundit fillimisht mendohej të zbatohet në fushën administrative, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka konsideruar atë të zbatueshme për çështjet administrative qysh nga viti 1971. Ndarja e juridiksioneve administrative është e një rëndësie të veçantë. Meqenëse u kërkohet të zgjidhin mosmarrëveshje ku përfshihen organe publike, gjyqtarët e çështjeve administrative janë të ekspozuar përballë një rreziku të lartë të të qenit të ndikuar apo që konsiderohen sikur janë të ndikuar nga pushteti ekzekutiv. Kështu, juridiksionet e veçanta priten që të japin të njëjtat garanci të paanësisë dhe pavarësisë si dhe gjykatat e zakonshme. Gjyqtarët e çështjeve administrative nuk duhet të jenë nëpunës civilë që pak a shumë shqyrtojnë ankesa administrative formale, por gjyqtarë të vërtetë dhe plotësisht të pavarur.

Gjykata mund të jetë një gjykatë administrative ose pjesë e sistemit të zakonshëm gjyqësor .

Ky parim plotëson të mëparshmin, duke përcaktuar karakteristikat e organit përgjegjës për shqyrtimin gjyqësor të akteve administrative. Ky u referohet të dy modeleve që ushtrohen tradicionalisht në vendet europiane, dmth, një juridiksion administrativ që është autonom dhe një që është i integruar në sistemin gjyqësor të zakonshëm. Këto modele shpesh janë vendosur kundrejt njeri-tjetrit duke e specifikuar të parin si një juridiksion administrativ “të specializuar”. Megjithatë, kjo kundërvënie nuk korrespondon domosdoshmërisht me ndonjë ndryshim thelbësor, pasi edhe sistemi gjyqësor i zakonshëm mund të sigurojë një shkallë të lartë specializimi duke krijuar dhoma ose seksione të çështjeve administrative, ashtu siç kanë bërë shumica e vendeve që kanë ruajtur unitetin e juridiksionit. Sidoqoftë, përse i takon përputhshmërisë me standardet europiane, të dy modelet janë të barabartë.

Vendimi i gjykatës që shqyrton një akt administrative, të paktën në çështjet e rëndësishme, duhet t'i nënshtrohet ankimit në një gjykatë më të lartë, përveç kur

çështja i dërgohet drejtpërdrejt gjykatës më të lartë administrative në pajtim me legjislacionin vendas<sup>20</sup>.

Megjithëse në bazë të Konventës për të Drejtat e Njeriut mjetet e ankimit nuk janë detyruese, kërkohet një e drejtë ankimi në shumicën e rasteve, me mendimin që mbrojtja e përshtatshme gjyqësore përfshin të drejtën për një gjykim të dytë. Megjithatë, është në kompetencën e Shtetit të vendosë kufirin brenda të cilit mund të bëhen ankime tek gjykatat më të larta dhe të specifikojnë juridiksionin e organit të ankimit. Meqenëse përfshirja e një instance më të lartë në gjykimin administrativ mendohet thelbësore për të garantuar njëtrajshmërinë e praktikës gjyqësore administrative, parimi nuk zbatohet nëse një çështje i dërgohet drejtpërdrejt gjykatës më të lartë në pajtim me ligjin e brendshëm.<sup>21</sup>

Personave fizik dhe juridik mund t'u kërkohet të ushtrojnë mjetet mbrojtëse të parashikuara nga ligji i brendshëm para se të kenë të drejtën e shqyrtimit gjyqësor. Procedura e ushtrimit të këtyre mjeteve mbrojtëse nuk duhet të jetë e tejzgjatur. Ushtrimi i mjeteve të tjera mbrojtëse para kërkimit të shqyrtimit gjyqësor bën të mundur parandalimin e ngarkesës së tepërt të punës për gjykatat duke ndikuar në efikasitetin gjyqësor. Kjo është në interes të gjyqësorit dhe administratës dhe mund të kontribuojë në pakësimin e shpenzimeve procedurale për individin.

Megjithatë, ky detyrim nuk duhet të ndalojë personat fizik dhe juridik të kërkojnë shqyrtimin gjyqësor të aktit administrativ duke e zgjatur gjykimin në tërësi në mënyrë të parregullt. Këshilli i Europës dhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) kanë luajtur një rol të veçantë në përcaktimin e standardeve në kontrollin gjyqësor të veprimtarisë së administratës publike. Këshilli i Europës ka miratuar disa rekomandime dhe ka shpërndarë informacion, dokumente dhe studime mbi praktikat më të mira. Bashkimi Europian, e kryesisht vendimet gjyqësore me fuqi ligjore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, ushtron një ndikim të rëndësishëm në përafrimin e traditave kombëtare mbi kontrollin gjyqësor. Këto vendime gjyqësore me fuqi ligjore, po influencojnë shtetet anëtare të BE-së sikundër edhe vendet candidate. Disa teknika që kanë ndezur debate si nocioni ligjor i përgjegjësisë dhe kontrolli i fuqive diskreciale, i kanë të gjitha rrënjët në legjislacionin e shteteve anëtare. Në këto rrethana, një numër i konsiderueshëm shtetesh anëtare të BE-së si dhe disa vende

---

<sup>20</sup> Nertila Brahimaj-punim I mbrojtur ne Dhjetor 2014, UNHZ-Peje

<sup>21</sup> Gilles Dutertre: Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, faqe 174 - 180



kandidate, janë duke rivlerësuar zgjedhjet organizative që kanë bërë si dhe rregullat procedurale të shqyrtimit gjyqësor mbi aktivitetet administrative.

Nëse pa administratën publike shoqëria do mund të jetonte, pa një kontroll të arsyeshëm, ligjor dhe të natyrshëm, nuk do mund të jetonim në një shtet të së drejtës, nuk do mund të jetonim me dinjitet, në një klimë të drejtësisë shoqërore dhe e mbizotërimit të rendit kushtetues. Në të kundërt do të gjendeshim përpara abuzimeve të pushtetit të këtyre organeve, pushtet që vetë shoqëria ua ka dhënë. Organizimi aktual i shqyrtimit administrativ të akteve administrative në Kosovë përputhet me Standardet Evropiane në lidhje me kompetencën e gjykatave të zakonshme, mjetet ligjore të mbrojtjes dhe kërkesën për të kërkuar vendimin e një organi më të lartë administrativ para se të vihet në lëvizje gjykata, që nuk e zgjat gjykimin në mënyrë të parregullt.

Megjithatë, ngritja e një sistemi gjyqësor administrativ autonom do të përputhej gjithashtu me Standardet Evropiane<sup>22</sup>, nëse do të garantoheshin pavarësia dhe paaftësia e gjykatave administrative dhe nëse do të parashikohej ankimim të paktën në çështjet më të rëndësishme ose nëse çështjet do të dërgoheshin drejtpërdrejt në një gjykatë më të lartë. Nëse së pari kërkesa për marrjen e një vendimi nga një organ më i lartë administrativ respektohet, duhet të kërkohej gjithashtu të sigurohen garancitë përkatëse për mënjanimin e zgjatjes së tepërt të gjykimeve.

Shqyrtimi ligjor i vendimeve administrative nga gjykata të pavarura është një parim demokratik i pranuar, i pranishëm në praktikën kryesore evropiane dhe një kontribut i rëndësishëm për të siguruar rendin, veçanërisht për të mbrojtur të drejtat individuale përballë administratës. Për më tepër, drejtësia administrative luan një rol vendimtar për zhvillimin ekonomik të një vendi. Pothuajse të gjitha vendimet për investime apo projekte për infrastrukturën, duhet të kalojnë përmes një procesi licënsimi, i cili mund të bëhet subjekt i një shqyrtimi ligjor nga gjykatat administrative. Gjykata efikase administrative rrisin gjithashtu transparencën e vendimeve administrative, gjithashtu mund të luajnë një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit dhe kontrolli gjyqësor i veprimeve publike administrative nga një gjyqësor administrativ që funksionon mirë është përveç pikëpamjes strikte ligjore të çështjeve individuale, edhe një forcë stimuluese për modernizimin e administratës publike, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve të saj dhe si pasojë, rrit besimin e qytetarëve për institucionet publike.

---

<sup>22</sup> Nertila Brahimaj-punim, mbrojtur në Dhjetor 2014, UNHZ-Peje

Shqyrtimi gjyqësor i veprimtarive qeveritare e ka origjinën e vet në filozofinë e shtetit që qeveriset dhe kufizohet nga ligji dhe bazohet tek parimi i epërsisë së ligjit. Në ditët e sotme, një shtet ligjor nuk mund të mendohet pa akses për të gjithë qytetarët tek një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar në bazë të ligjit dhe e aftë për të përmbushur kërkesat e zhvillimit të një gjykimi të drejtë. Si i tillë, roli i shqyrtimit gjyqësor i veprimtarisë administrative është të mbrojë të drejtat e qytetarëve, por edhe të mbrojë interesin publik dhe rendin ligjor. Krahas këtij roli mbrojtës, kontrolli gjyqësor shihet si një mjet i rëndësishëm në rritjen e cilësisë së administrimit dhe qeverisjes së mirë.

Njëkohësisht, zgjerimi i sektorit publik dhe rritja e kompleksitetit të vendim-marrjes administrative ka një ndikim të dyfishtë: nga njëra anë ka sjellë forma të reja të aktivitetit administrativ dhe rritje të kërkesës për fleksibilitet të administratës në shërbim të interesit publik dhe nga ana tjetër efektet e një zgjerimi të tillë mbi jetën individuale janë duke u rritur vazhdimisht. Në këto kushte, për të kundërpeshuar efektet, nevojitet një fuqi e mirëkonfiguruar vlerësimi për administratën dhe forcimi i kontrollit gjyqësor mbi veprimtaritë e veta. Kjo vendos përherë e më tepër në pikëpyetje qasjet tradicionale ndaj intensitetit dhe shtrirjes së shqyrtimit gjyqësor mbi aktivitetin e administratës<sup>23</sup>. Përveç kësaj nevoje të brendshme dhe natyrale për ta rishikuar qasjen tradicionale, kemi edhe një numër përherë e më të madh parimesh ligjore që rregullojnë hapësirën evropiane, të cilat po ndikojnë fuqishëm zhvillimet në fushën e kontrollit gjyqësor të administratës publike.

Ne një shtet të së drejtës, administrata publike është e ngarkuar me një mori detyrimesh kundrejt qytetarëve dhe anasjelltas dhe për rrjedhojë garantuesja e një ekulibri të arsyeshëm midis administratës shtetërore dhe individit, midis interesit publik dhe atij privat është padyshim gjykata. Për këtë arsye kontrolli i administratës publike më shumë se i nevojshëm është i domosdoshëm në shoqërinë tonë. Vetëm nëpërmjet një kontrolli të tillë do të mund të sigurohet një respektim maksimal i të drejtave dhe lirive themelore dhe do mund të vihen në jetë konceptet e pranuar në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë Veriore, lidhur me kufijtë e veprimtarisë së shtetit, që përcaktohet nga e drejta.

---

<sup>23</sup> Po aty

## **KAPITULLI - III :**

### **I. GJYQËSIA ADMINISTRATIVE NË RMV**

#### **1.Historiku i Gjyqësisë administrative në RMV, 1991-2006, 2006-2010 dhe 2010- e këndej**

Sipas regullativës normativo-juridike të procedurës administrative gjyqësore, zhvillimin e konfliktit administrativ në RMV mund t'a shqyrtojmë në tre periudha kohore.

Periudha e parë , nga pavarësimi i RMV deri ne miratimin e Ligjit për konfliktet administrative të vitit 2006.

Periudha e dytë, prej vitit 2006 deri në vitin 2010 kur u miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e LKA.

Periudha e tretë, nga viti 2010 deri në ditet e sodit, 2022.

#### **1.1 Gjyqësia administrative në RMV prej vitit 1991 - 2006**

Karakteristika themelore e kësaj periudhe kohore është ekzistimi i Ligjit të veçantë për Konfliktin administrativ dhe kompetenca gjyqësore e Gjykatës Supreme të RMV. Pra, në këtë periudhë aplikohet LKA i vitit 1977, i cili në pjesë të caktuara ishte i harmonizuar me regullimin e ri politik të bazuar në parimin e ndarjes së pushtetit, ekonomisë së tregut si dhe pluralizmit politik<sup>24</sup>.E drejta mbrojtjes së gjyqësisë administrative ishte e garantuar me Kushtetutën e RM në sajë të së cilës garantohej mbrojtja gjyqësore e ligjshmërisë së akteve konkrete të administratës shtetërore dhe të institucioneve tjera te cilat ushtrojnë autorizime publike<sup>25</sup>.

Asokohe, KA në Gjykatën supreme procesuohej përmes dy dhomave (kolegjeve) administrative të cilat ishin të themeluara enkas për zgjidhjen e lëndëve nga materia

---

<sup>24</sup> Ligji për konflikte administrative(Gazeta zyrtare e RSFJ Nr..4/77 dhe 36/77);

<sup>25</sup> Neni 50 i Kushtetutës së RM, (Gayeta zyrtare e RM, nr..52 e 22.11.1992 vitë);

juridiko-administrative, ngase Gjykata supreme eshte edhe gjykata me e larta per lende penale dhe civile.

Ajo e cila është dalluese në praktikën pesembëdhjetvjeçare të procesimit të konflikteve administrative nga ana e Gjykatës supreme ishte rritja permanente e konflikteve administrative, ngelja permanente e lëndëve të pazgjedhura që reflektonte në mosefikasitetin e punës së Gjykatës supreme të RM.

Nevoja e pashmangëshme e shkarkimit të lëndëve në GJS dhe arritja e efikasitetit më të madhe në sigurimin e mbrojtjes së gjyqësisë administrative si dhe nevoja më e ngushtë e specializimit dhe profesionalizimit të gjykatësve ishte një pjesë e arsyes në mesin e shkenctarëve, teoricientëve, praktikentëve, si dhe publikut më të zgjeruar, hapi nevojën e diskutimit për miratimin e një Ligji për Konfliktin administrativ, i bazuar në principe dhe vlera të reja evropiane.

**Tabela 1.**

**Lëndët në punim në Dhomën administrative të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë , në periudhën kohore 2000-2006<sup>26</sup>**

Viti	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
<b>Numëri i përgjithshëm i lëndëve në dhomën administrative</b>							
	5636	5379	5169	6299	6793	7556	7506
<b>Të pazgjidhur nga viti paraprakë</b>							
	3273	3036	2634	3156	4139	4140	4067
<b>Të pranuar në vitin vijues</b>							
	2363	2316	2535	3143	2654	3316	3439
<b>Të zgjidhura</b>	2573	2745	2013	2160	2553	3490	4150
<b>Pazgjidhura</b>	2063	2634	3156	4139	4240	4066	3491

<sup>26</sup> Raporti i punës së Gjykatës supreme të RM, 2000-2007 vitë;

Fella akademike dhe opiniononi profesional nga ana tjetër, qendrimin e tyre për nevojën e miratimit të Ligjit të ri për KA e argumentonin me argumente se një zgjidhje e tillë do të siguronte:

- efikasitet më të lartë në zgjidhjen e KA;
- specializim adekuat të gjykatësve të ardhshëm, e cila parashikon shkathtësi të veçanta, kualifikim, trajnim dhe rëndësi;
- zgjidhje më të sheshtë të zgjidhjeve meritore të KA;
- krijimi i kushteve për praktikë të gjyqësisë administrative me kredibile për lëmin e materies administrative;

Arsyeshmeria e konstituimit të gjyqësisë në RM mund të shqyrtohet kryesisht në tre drejtime:

- **I pari**, ka të bëjë parasegjithash me interesin e qytetarëve për shkaqe të zgjidhjes së konflikteve administrative-juridike kundrejtë aktvendimeve administrative si dhe mbrojtjen gjyqësore të drejtave të njeriut, kur janë të cënuara nga ana e administratës publike;
- **I dyti**, katë bëjë me shkarkimin e Gjykatës supreme nga lëndët që kanë të bëjnë me konfliktet administrative ;
- **I treti**, është në interes të Qeverisë së RM si mbartës i pushtetit egzekutiv-administrativ dhe se kontrolli gjyqësor administrativ do të garantonte një veprimtari administrative me efikasitet dhe efektive dhe dotë ndikojë parasegjithash në depolitizimin e administratës dhe profesionalizimin e sajë.

## 1.2 Gjyqësia administrative në RMV prej vitit 2006 -2010

Baza juridike për themelimin, organizimin dhe funksionimin e Gjykatës administrative, parimisht është e përcaktuar në nenin 22 të Ligjit për gjykatat, në bazë të cilit pushtetimi gjyqësor e ushtrojnë gjykatat themelore, gjykatat e apelit, Gjykata administrative dhe Gjykata supreme e RMV<sup>27</sup>.

---

<sup>27</sup> Ligji i gjykatave, (Gayeta zyrtare e RM, nr...58/06 i 11.05.2006 vitë);

Procedura dhe kompetenca e Gjykatës administrative detajisht është e përcaktuar me Ligjin e konflikteve administrative, derisa për disa qështje të caktuara është më ngusht e lidhur edhe me Ligjin e procedurës së përgjithshme administrative<sup>28</sup>, si dhe me ligje tjera materiale dhe procedurale<sup>29</sup>. Edhe pse Ligji për konfliktet administrative i vitit 2006 kishte veprimtari të prolonguar për një vitë edhe Gjykata administrative duheshite të filloj me punë në Maj të viti 2007, për shkakë të pamundësisë së zgjedhjes së gjykatësve në afatin e parapare ligjorë, gjykata filloi me punë me 05 e dhjetorit 2007, me pranimin e 5409 lëndëve të pazgjedhura nga lëmia administrative prej Gjykatës supreme në RMV<sup>30</sup>.Kjo nënkupton se që në fillim Gjykata administrative startoi si joefikase ngase ishte e stërngarkuar me lëndë të pazgjedhure ndërsa Gjykata supreme u shpall si jo kompetente për lëndët administrative në bazë të Ligjit për konfliktet administrative ajo vetëm bënte pranimin e parashtrimit të padive që te ruhet afati ligjor i parashtrimit të padive.

Kjo periudhë kohore ishte periudha më e vështirë e gjyqësisë administrative.Edhe pse njëra ndër qëllimet e formimit të gjykatës së specializuar përkatësishtë të Gjykatës administrative ishte ritja e fikasitetit dhe efektivitetit të zgjidhjes së konflikteve administrative dhe mbrojta gjyqësore e të drejtave të personave juridik dhe fizik nga lëmia administrative, Gjykata administrative në periudhën e konsolidimit të sajë hasi në vështërsi të theksuara.

Gjykata administrative që nga themelimi i saj e deri në vitin 2011 hasi në vështirësi si nga aspekti i organizimit të saj, nga aspekti kadrovik dhe ekipimit profesional dhe të specializimit të tyre, nga mospërvoja dhe tërheqja e Gjykatës supreme nga konflikti administrativ dhe grumbullimi i lëndëve të pazgjidhura si dhe pranimin e lëndëve të reja administrative. Kjo vështirsi detyroi autoritetet kompetente shtetërore që të marrin masa në drejtimin e reformimit të gjyqësisë administrative si nga aspekti materialo-organizativ edhe nga aspekti formalo-normativ.

---

<sup>28</sup> Ligji i procedurës së përgjithshme administrative, (Gayeta zyrtare e RM, nr...38/2005, me ndryshime dhe plotësime);,

<sup>29</sup> Për shembull, neni 7 i Ligjit për konfliktet administrative tregon ybatimin e Ligjit të procedurave kontestimore në rastet kur Ligji për kontestet administrative, nuk përmbanë dispozita për procedurën e kontesteve administrative;

<sup>30</sup> Raporti i punës së Gjykatës administrative për vitin 2008;

Në favorë të kësaj situate të Gjykatës administrative, flasin edhe të dhënat empirike të Raporteve për punën e Gjykatës administrative në kontuniutet që nga themelimi i sajë e deri ne vitin 2017<sup>31</sup>.

Ajo që mund të konstatohet në ket periudhë, është se risia më e rëndësishme në përmbajtjen e Ligjit e cila ishte edhe arsyeja kryesore për shtyerjen e miratimit të tij si dhe prollongimin e veprimit të të tij, ishte formimi i Gjykatës administrative në RM. Përveçë kësaj, me Ligjin e konflikteve administrative-2006, u bë edhe zgjerimi i lëndëve të konflikteve administrative si dhe reduktimi i mjeteve të jashtëzakonshme juridike në procedurën administrative gjyqësore dhe mund të thuhet seil tërë koncepti i konfliktit administrative u ndryshua ashtu qe nga konflikti i kontrollit të ligjshmërisë ai u ridimenzionua në konflikt të juridiksionit të plotë.

## **1.2 Gjyqësia administrative në RMV prej vitit 2010 deri me 2022**

Kjo periudhë e zhvillimit të gjyqësisë administrative në RMV karakterizohet me miratimin e Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për konfliktet administrative të vitit 2010, ideja ose koncepti esencial i së cilit ishte, parashikimi i ankesës si mjet i rregullt juridik në procedurën gjyqësore administrative dhe themelimin e Gjykatës së lartë administrative si gjykatë kompetente për të vendos në bazë të ankesave ndaj aktvendimeve të Gjykatës administrative, e cila filloi të funksionojë me 30.06.2011.

- ***Çka i parapriu një zgjidhjeje të tillë ligjore dhe a thua se me të vërtetë u bë një reformë pozitive në gjyqësinë administrative në RMV ?***

Siç është theksuar edhe më lartë, ankesa në konfliktin administrativ ka qenë përjashtim në sistemin tonë juridikë. Procedura gjyqësore administrative nuk duhet kuptuar si procedurë kontestimore. Përkundrazi, roli i Gjykatës administrative duhet të jetë para së gjithash kasacionale, gjë që është edhe qëllimi esencial i konfliktit administrativ ,pra konstatimi i ligjshmërisë së aktit administrativ.

---

<sup>31</sup> Raporti i punës së Gjykatës administrative për vitin 2008, ( sqarimi sipas indikatorit të efikasitetit të punës së së Gjykatës administrative).објаснува исполнување на индикаторот за ефикасност на управното судство.

Meqenëse, në Ligjin për konfliktet administrative të vitit 2006 nuk ekzistonte dispozitë për ankesën, në praktikë u paraqiten probleme të caktuara dhe anomali të caktuara në raport me këtë çështje. Në esencë, ligji i lartpërmendur në asnjë menyrë nuk e rregullonte çështjen e ankesës dhe nuk parashihte organ kompetent për vendosje sipas ankesës, as në formën organizative e as në ato normative<sup>32</sup>.

Kjo gjendje zgjati deri në dhjetor të viti 2009 kur Gjykata supreme e RM solli qëndrim parimor me të cilin u shpall si kompetente për vendosjen në bazë të ankesës, mirëpo edhe kjo zgjidhje nuk mbijetoi gjatë<sup>33</sup>.

Pra, një kaos i tillë juridiko-procedural e imponoi nevojën e pashmangshme për një Ligjë të ri për konfliktet administrative në të cilin në menyrë të veçantë do të rregullohet kjo çështje, e njikohësisht do të rregullohen dhe precizohen më shumë çështje dhe institute juridike, si rezultat i së cilës në nëntor të vitit 2010 u miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e konflikteve administrative i cili e rregulloi çështjen e ankesës si mjet i rregullt juridik dhe Gjykatën e lartë administrative si organ kompetent i shkallës së dytë në konfliktet administrative<sup>34</sup>.

Sot, gjyqësia administrative është më e etabluar si nga këndvështrimi organizativ, strukturoro-kadrovik si dhe nga aspekti normativ gjegjësishtë proceduralo-juridiko administrativ.

## **2.Organizimi i Gjykatës Administrative në RMV**

Në RMV kontrolli i përgjithshëm gjyqësorë mbi organet e administratës publike bëhet nëpërmjet :

- shfrytëzimit të mjeteve juridike në procedurën penale për përgjegjësinë penale të personave zyrtarë në administratën publike,
- përdorimi i mjeteve juridike në procedurën civile, kur punohet për përgjegjësinë nënpunësve publikë për dëmet materiale ndaj personave fizik dhe juridik,

---

<sup>32</sup> Analiza funksionale e kapaciteteve të gjyqësisë administrative RM, 31/08/18, fq.11

<sup>33</sup> Qëndrimi parimor i Gjykatës supreme, 24.12.2009. "Gjykata supreme e RM është gjykatë kompetente te veproji sipas ankesës së parashtruar kundër aktgjykimeve të Gjykatës administrativebtë sjellura pas hyrjes në fuqi të Vendimit të Gjkatës kushtetuese të RM, , Nr.adm..231/2008 i 16. shtatorit 2009 vitë („Gazeta zyrtare RM“ nr.117/2009 i 25. Shtator i vitit 2009 ), me të cilin ndërpritet neni 39 paragrafi 2 i Ligjit të konfliktit administrativ („Gazeta zyrtare e RM“ nr.62/2006),

<sup>34</sup> Neni 2, në neni 22 pas fjalëve Gjykata administrative vihet presja dhe shtohetn fjalët Gjykata e lartë administrative, i cili vendos sipas ankesës ndaj aktëgjykimeve të Gjykatës administrative në tërë territorin e Republikës.



- kontrolli kushtetuese-juridike ndaj akteve të përgjithshme administrative,
- zgjidhja e konflikteve administrative kundër akteve përfundimtare konkrete administrative gjegjësishtë kontrolli gjyqësor administrative.

Lloji i fundit i kontrollit gjyqësor karakterizohet edhe si konflikt administrativ dhe paraqet një lloj kontrolli të jashtme mbi punën, gjegjësishtë ligjshmërinë e akteve konkrete të organeve të administrates shtetërore si dhe të organeve dhe institucioneve tjera me autorizime publike për kryerjen e punëve administrative.

Në saje të strukturës organizative dhe zbatimit të kontrollit gjyqësor të administrates, në botë janë të identifikuara tre sisteme<sup>35</sup>, edhe atë:

- sistemi anglosankson;
- sistemi kontinentalo-evropian;
- sistemi i përzier.

Tipari esencil i modelit anglosankson është se ky kontroll bëhet nga gjykatat e regullta dhe ai zbatohet në procedurën e regullt gjyqësore sipas regullave të së drejtës së përgjithëshme-common law.

Modeli kontinentalo-evropian karakterizohet me ndarjen në gjykata të veçanta administrative kompetente për zgjidhjen e konflikteve administrative dhe procedura të veçanta në zgjidhjen e tyre.

Sistemi i përzier ka premisa të caktuara nga të dy sistemet e para.

Në RMV, deri në vitin 2006 kur për herë të parë pas pavarësimit të Maqedonisë, u miratua Ligji i ri për konfliktet administrative. Para këtij ligji, tek ne ishte i pranishëm koncepti i përzier i regullimit të gjyqësisë administrative.

Republika e Maqedonisë së Veriut si vend i cili kaloi tranzicionin si dhe pretendente për hyrje në familjen evropiane, gati dy decenie po bën reformat e caktuara normativo-juridike dhe institucionale në shumë sfera a veçanërisht në jurisprudencë dhe administratë publike, me cka aspiron t'i përmbush kriteret evropiane dhe të krijoj sistem juridik të bazuar në vlerat dhe standardet evropiane.

---

<sup>35</sup> Simeon Gelevski, Upravno procesno pravo, 1997 fq.243

Një pjesë e reformave është bërë edhe në kontrollin gjyqësor administrative, me etablimin e gjyqësisë administrative dhe instalimin e Gjykatës administrative dhe Gjykatës së lartë administrative, me futjen e ankesës si mjet i rregullt juridikë në procedurën gjyqësore administrative, pra tash aplikon pastër sistemin kontinentalo-evropian.

### **3.Shkallëzimi i procedimit gjyqësorë në gjyqësinë administrative në RMV**

Njëra ndër çështjet esenciale të zgjidhjes së konfliktit administrativ, është edhe procedura e procedimit gjyqësor në gjykatat administrative. Procedimi gjyqësorë në sistemet e kontrollit të ligjshmërisë së akteve administrative nga ana e gjykatave administrative nuk është i njejtë por kryesisht në sistemin kontinentalo-evropian, ndeshen dy modele të shkallshmërisë së organizimit të gjykatave administrative, edhe ate:

- modeli dyshkallësh;
- modeli treshkallësh.

Dyshkallshmëria e gjyqësisë administrative, kryesishtë haset tek 11 shtete, ndërsa treshkallshmëria haset tek 15 shtete të kontrollit të administratës dhe akteve administrative nga ana e gjykatave administrative.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, fillimisht me aplikimin e gjyqësisë administrative, respektivisht zgjidhjen e konfliktit administrativ nga ana e Gjykatës administrative me Ligjin e ri për konfliktet administrative, ku nuk ishte i paraparë instituti i ankesës, funksiononte dyshkallshmëria e procedimit gjyqësor. Në shkallë të parë , Gjykata administrative dhe në shkallë të dytë Gjykata supreme. Njëshkallshmëria e Gjykatës administrative u tregua si joefikase dhe solli shumë komplikime në zgjidhjen e konflikteve administrative. Për këte arsye, me Ligjin e ri për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për konfliktet administrative të vitit 2010, ku u parapa edhe ankesa si mjet i rregullt juridik u aplikua edhe Gjykata e lartë administrative. Në sajë të kësaj reforme ligjore në Maqedoninë Veriore, filloi të zbatohet procedimi gjyqësor treshkallësh.

Në bazë të kësaj zgjidhjeje ligjore, konfliktet administrative në Republikën e Maqedonisë Veriore i zgjidhin:

- Gjykata administrative, si gjykatë e shkallës së parë;
- Gjykata e lartë administrative, si gjykatë e shkallës së dytë;
- Gjykata supreme e RMV, si gjykatë e shkallës së tretë<sup>36</sup>.

Ashtu që, sot Gjykata administrative në konfliktin administrativ, vendos në shkallë të parë, në saje të padisë kundër aktit administrativ.

Gjykata e lartë administrative, vendos në saje të ankesave kundër vendimeve të Gjykatës administrative te sjellura në shkallën e parë.

Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë Veriut, vendos në saje të mjeteve te jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të Gjykatës së lartë administrative<sup>37</sup>.

## **7. Zgjedhja dhe statusi i gjykatësve në Gjykatat administrative**

Gjykatësit në Gjykatën administrative, si kategori e veçantë e gjykatësve u inkorporuan në sistemin gjyqësorë përmes Ligjit të konflikteve administrative dhe Ligjit për gjykatat të vitit 2006. Me formimin e Gjykatës administrative si gjykatë e pare e specializuar në Republikën e Maqedonisë Veriore pas reformës së vitit 1995, ligjdhënësi kishte idenë që kjo gjykatë të jetë gjykatë e lartë e specializuar, e cila do t'ia marrë në tërësi kompetencat Gjykatës supreme dhe do të fillojë të bëjë kontroll gjyqësor njëshkallësh të administrates publike.

Gjykata administrative me formimin e saj, ishte e planifikuar të ketë 19 gjykatës<sup>38</sup> gjegjësishtë 6 këshilla prej nga 3 gjykatës dhe kryetarin. Në pajtueshmëri me Ligjin për gjykatat i viti 2006, gjykatës në Gjykatën administrative mundej të zgjidhet personi i cili kishte:

- Më së paku pesë vjetë përvojë pune në gjykatë, me rezultate të konstatuara në punë;

<sup>36</sup> Neni 4 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e LKA (Gazeta zyrtare RM, nr. 150 dhe 18.11.2010 vitë);

<sup>37</sup> Neni 16, i po të njëjtit ligjë;

<sup>38</sup> Neni 16 i LKA („G.zyr. e RM“ nr. 62/2006)

- Ose tetë vjet përvojë pas dhënjes së provimit të jurisprudencës, në punë juridike;
- Profesorë universitarë nga lëmia e drejtësisë me titull shkencorë doktorë i shkencave juridike<sup>39</sup>.

Këto kushte ishin identike, me kushtet e zgjedhjes së gjykatësve në gjykatat e apelit edhe pse për nga statusi dallojnë në kompetencën vendore ngase gjykatësit administrativ gjykojnë për tërë territorin e Republikës ,ndërsa ato të apelit vetëm për një territory apelativë<sup>40</sup>. Dallimi ishte edhe në roga ngase gjykatësit administrativë gjindeshin në mes të gjykatësve të apelit dhe gjykatësve të Gjykatës supreme<sup>41</sup>.

Me ndryshimet e Ligjit për gjykatat të vitit 2008, reduktohen kushtet për gjykatës të Gjykatës administrative me arsyetim se në bazë të nenit 46 parashihet se “ për gjykatës të Gjykatës administrative mund të zgjidhet personi i cili ka pesë vite përvoj pune pas dhënjes së provimit të jurisprudencës, punë juridike, ose gjykatës profesor universitarë në momentin e paraqitjes për tu zgjedhur, nga lëmia e drejtësisë me titull shkencorë doktor i shkencave juridike”. Ndërsa, me ndryshimet e vitit 2010<sup>42</sup> përsëri kriteret e veçanata u zvogluan sepse për gjykatës në Gjykatën administrative, mund të zgjidhet personi i cili ka përvoj pune më së paku katër vite pandërprerë si gjykatës në gjykatëm themelore deri në momentin e paraqitjes për zgjedhje dhe i cili vitin e fundit nga ana e Këshillit gjyqësor është notuar me notën më të lartë pozitive dhe në raport me personat tjerë të praqitur ka fituar numër më të madh pikesh, në pajtueshmëri me ligjin, ose personi i cili ka më së paku pesë vite përvojë pune në organet shtetërore me rezultate të mira në punë dhe me notë pozitive të lartë, vitin e fundit të punës.

Ndërsa, për gjykatës në Gjykatën e lartë administrative, Ligji për gjykatat parasheh se për gjykatës në Gjykatën e lartë administrative, të zgjidhet personi i cili ka përvojë pune më së paku tre vite pandërprerë si gjykatës në Gjykatën administrative dhe i cili vitin e fundit nga ana e Këshillit gjyqësor të jetë vlersuar me notë të lartë pozitive dhe të ketë më shumë pikë nga konkurentët e paraqitur, si dhe personi i cili ka gjashtë vjetë përvojë pune në lëminë juridike në organë shtetërorë me rezultate të mira

<sup>39</sup> Neni 46 i Ligjit për gjykatat („G.zyr. e RM“ nr. 58/2006)

<sup>40</sup> Neni 25 i Ligjit për gjykatat („G.zyr. e RM“ nr. 58/2006)

<sup>41</sup> „- grupa e tretë i përfshinë gjykatësit dhe kryetarët e Gjykatave të apelit, e katërta të Gjykatës administrative dhe e pesta të Gjykatës supreme të RM.“

<sup>42</sup> Neni 17 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të gjykatave („Gazeta zyrtare e RM“ nr. 150/2010)

në punë dhe me notë më të lartë pozitive, sipas ligjit<sup>43</sup>, në këtë mënyrë u mbyll mundësia e fluktuimit në profesionin juridik nga profesionet tjera, si psh. Avokatët, praktikientët të dalluar juridik, profesor të drejtësisë, etj.

Pas themelimit të Gjykatës së lartë administrative, u parashtrua pyetja e statusit të hieriarkisë institucionale. Me qëllim që të ngelet në metodologjinë e njejtë institucionale, gjegjësisht se Gjykata e lartë administrative është gjykatë e ankimimit për vendimet e Gjykatës administrative., hierarkia institucionale e Gjykatës së lartë administrative, është ne mes të Gjykatës administrative dhe Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë Veriore. Në vijueshmërinë e saj, në vitin 2011 u bë intervenimi në ndryshimin e Ligjit për rrogat e gjykatësve dhe u bë kategorizimi i gjykatësve sipas rrogave, edhe ate:

- Kategoria e 4, gjykatesit e Gjykatës administrative;
- Kategoria e 5, gjykatësit e Gjykatës së lartë administrative;
- Kategoria e 6, gjykatësit e Gjykatës supreme<sup>44</sup>.

Me ndryshimet e fundit, në fakt u mundësua që nënpunësit shtetërorë, të bëhen gjykatës në Gjykatën administrative dhe Gjykatën e lartë administrative, gjegjësisht juristë të cilët nuk kishin asnjë përvojë gjyqësore, gjë që është shumë diskutabile për arsye se punohet për dy gjykata që ndodhen në mes të gjykatave të apelit dhe Gjykatës supreme. Nëse merren parasysh zgjedhjet e fundit për gjykatës në gjyqësinë administrative, gati se asnjë gjykatës nuk ka ardhur nga fella e gjykatësve por të gjithë gjykatësit administrativ vijnë nga rradha e nënpunësve të organeve shtetërore, të cilët s'kanë asnjë njohuri nga procedurat gjyqësore.

#### **4.1 Shkarkimi i gjykatësve në gjykatat administrative**

Procedurën e shkarkimit të gjykatësve në Republikën e Maqedonisë Veriore, e inicon ekskluzivisht Këshilli gjyqësor. Kjo mënyrë e shkarkimit sipas Ligjit mbi gjykatat, në parim, ofron një siguri dhe mbrojtje më të madhe për gjykatësit, sepse

---

<sup>43</sup> Ibid

<sup>44</sup> Pas alinesë 4 shtohet alinea 5, e cila thotë: „- grupa e pestë i përfshinë gjykatësit dhe kryetarin e Gjykatës së lartë administrative dhe neni 1 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për rrogat e gjykatësve („Gazeta zyrtare e RM“ nr. 135/2011)

iniciativa për shkarkimin e gjykatësve vjen ekskluzivisht nga gjyqësori si degë e mëvetësishme e pushtetit, me çka zvogëlohet presioni ndaj gjyqësorit i cili nxitej nga degët tjera të pushtetit (legjislativit dhe ekzekutivit).

Në bazë të Ligjit për gjykatat, gjykatësi mundet të shkarkohet nga pozita e gjykatësit, për këto dy shkaqe, edhe ate:

- Shkeljet e rënda disiplinore, të cilat e bëjnë të pandershëm ushtrimin e funksionit gjyqësor sipas ligjit;
- Për shkak të ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm në ushtrimin e funksionit gjyqësor, sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

Me shkelje të rënda disiplinore, për shkak të së cilave inicohet procedura e shkarkimit, konsiderohen:

1. Antarsimi në parti politike;
2. Pamundësia e ushtrimit të mbykqyrjes në punën e gjykatës nga gjykata më e lartë;
3. Shfrytëzimin e funksionit të vet dhe autoritetin e gjykatës për realizimin e interesave të veta private;
4. Shkëlja e rrëndë e rendit dhe qëtësisë publike me të cilën priset autoriteti i gjykatës dhe autoriteti i tijë i konstatuar me vendim të plotëfuqishëm gjyqësorë;
5. Vlerësimi dy herë rradhazi me nota të dobta nga ana Këshillit gjyqësorë që konsiderohet jo profesional dhe i pandërgjegjshëm në ushtrimin e funksionit gjyqësor;
6. Ushtrimin e një funksioni tjetër i cili nuk është kompatibil me atë të gjykatësit;
7. Pranimi i dhuratave dhe shfrytëzime tjera në lidhje me punën e gjykatës;
8. Gjatë marrjes së vendimeve nuk i aplikon qëndrimet e shprehura në aktgjykimin përfundimtar të Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut;
9. Paraqet apo zbulon informata të besuara të cilat i ka kuptuar duke u marrë me lëndën ose duke ushtruar funksionin e gjykatësit.

Në pajtueshmëri me Ligjin për gjykatat, për shkeljet e rënda disiplinore, kryetari i gjyqit është i obliguar në afat prej 8 ditësh nga dita e kryerjes së shkeljes, t'a lajmërojë Këshillin gjyqësor, për çka kryetari I gjykates përkujdeset ex officio.

Procedura disiplinore për konstatimin e përgjegjësisë disiplinore të gjykatësit, është e regulluar me Ligjin e Këshillit gjyqësorë të RMV.<sup>45</sup>

Procedura për konstatimin e përgjegjësisë së gjykatësit, inicohet në afatë prej 6 muajshë nga dita e dënjës së kryerjes së shkeljes por jo më vonë se tre vjetë nga dita e kryerjes së shkeljes. Proceduar është urgjente dhe e besueshme, gjegjësisht udhëhiqet pa praninë e publikut. Me kërkesën e gjykatësit, Këshilli do të vendosë që procedura të udhëhiqet me prezencën e publikut por mundet edhe mos ta marrë parasyshtë kërkesën e gjykatësit.

Me ushtrimin jo profesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit gjyqësor, nënkuptojmë ndikimin në mos efikasitetin dhe azhuritetin e punës së gjykatësit. Këtu bëjnë pjesë më shumë rrethana të cilat në mënyrë taksative numërohen në tekstin e Ligjit të gjykatave<sup>46</sup>.

Procedura për konstatimin e ushtrimit të funksionit gjyqësor si joprofesional dhe i pandërgjegjshëm njëloj si konstatimi shkeljeve të rënda disiplinore, rregullohet me Ligjin për Këshillin gjyqësor.

Prej themelimit të gjykatave administrative (Gjykatës administrative dhe Gjykatës së lartë administrative), asnjë gjykatës nuk është shkarkuar për arsyet e lartpërmendura.

## **8. Sfidat e Gjyqësisë administrative në RMV**

Sundimi i së drejtës dhe sovraniteti qytetarë, mundësuan forcimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut e veçanarishtë liritë dhe të të drejtat individuale, fituan karakter të pakontestueshëm, veçanarisht përmes konfliktit administrativ dhe praktikimit të drejtës administrative.

---

<sup>45</sup> Ligji i këshillit gjyqësorë të RM („Gazeta zyrtare e RM“ nr. 60/2006, 69/2006, 150/2010, 100/2011, 20/2015 dhe 61/2015)

<sup>46</sup> Sipas Ligjit për gjykatat („Gazeta zyrtare e RM“ nr. 58/2006.) Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat („Gazeta zyrtare RM“ nr. 150/2010) në mënyrë taksative i numronë arsyet e mos efikasitetit, joprofesionalitetit dhe azhuritetit të punës së gjykatësve.

Përmes konfliktit administrativ garantohen të drejtat individuale të qytetarëve dhe personave juridikë dhe viteve të fundit ka lëvizshmëri në garantimin e të drejtave të njeriut edhe me sjelljen e rregullativës ligjore, me qëllim që qytetarët më lehtë ti realizojnë të drejtat e tyre dhe rregullohen raportet në mes qytetarëve dhe shtetit. Mirpo, një është e sigurtë ngase shpeshë pas garantimit deklarativë të drejtave të njeriut, pushteti duke e shfrytëruar pozitën e ty zyrtare bënë cënimin e tyre, për mbrojtjen e interesit publikë<sup>47</sup>.

Sipas analizës empirike për nevojën e sjelljes së Ligjit të ri për konfliktet administrative të vitit 2006 në periudhën e kaluar u hasën shumë dobësi në aspektin e sterzgjatjes së konfliktit administrativ, mosvendosja e Gjykatës sipas juridiksionit të plotë, moszbatimi i vendimeve të sjelluara nga Gjykata administrative dhe anomali tjera, të cilat sollën probleme dhe vështërsi tek qytetarët për realizimin e të drejtave të tyre në konfliktin administrativ.

Njëkohësisht, është konstatuar edhe prolongimi i konflikteteve administrative, kur në procedurën sipas ankesës, organet publike përfaqësoheshin nga Avokati i shtetit. Problemet dhe rrezistenca e organeve publike me të cilët qytetarët ballafaqohen në zbatimin e së drejtës, sollën në situatë që të kërkohen mekanizma juridik për zgjidhjen e tyre në procedurë gjyqësore administrative dhe të vjen deri tek arsyetimi i Ligjit të ri për konfliktet administrative<sup>48</sup>.

Në Ligjin e ri për konflikte administrative<sup>49</sup>, është paraparë përsëri në konfliktin administrative të vendoset për ligjshmërinë e akteve të veçanta të Kuvendit, Qeverisë dhe organeve tjera publike me qëllim që të sigurohet mbrojtje gjyqësore, edhe pse me vendim të Gjykatës kushtetuese<sup>50</sup> është ndërprerë dispozita identike, neni 2 pika 2 e Ligjit të vjetër.

Risitë me ndryshimet dhe plotësimet e rregullativës ligjore për konfliktet administrative, janë të orientuara kah vendosja e juridiksionit të plotë, vendimet model si institutë i ri dhe mbrojtje e respektimit të mendimit juridikë, të dhena në aktgjykimet. Nga aspekti i mbrojtjes së konfliktit administrativë dhe vendimeve

---

<sup>47</sup> Насковска., Е., Казненоправни аспекти на злоупотреба на власта во Република Македонија, докторска дисертација, Правен факултет Јустинијан Први, Скопје, 2019

<sup>48</sup> Водич за примена на Законот за управни спорови, Септември, 2020 година, fq.19

<sup>49</sup> Neni 3 pika 5 e Ligjit për konflikte administrative (G.zytr. e PM nr.96/2019)

<sup>50</sup> Vendimi i Gjykatës kushtetuese të PM У nr.75/2007 e 13 02.2008 vitë



fuqiplote nga veprime joligjore të personave zyrtarë dhe pjesmarësve tjerë në procedurë, është paraparë instituti i ri dënim me të holla<sup>51</sup>, si mekanizëm për disiplinimin e mbartësve të funksioneve publike. Gjykata është e detiruar procedurën ta zhvilloj pa shtyerje të procedurës, në afat të kuptueshëm, me sa ma pakë harxhime dhe të pamundësojë të gjitha keqpërdorimet e të drejtave që u takojnë palëve në procedurë (neni 90). Ligji i ri për konfliktet administrative në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare e përcaktonë aplikimin e ligjit, edhe ate:

- Për të gjitha konfliktet administrative të filluara sipas ligjit të vjetër të vayhdojnë sipas ligjit të vjetër, a për të gjitha paditë e reja nga data 25.05.2020, të zbatohen dispozitat e reja, si dhe jepë drejtime për aplikimin e ligjit në procedurën sipas mjeteve juridike (neni 91).

Me Ligjin e ri për konfliktet administrative, pritet të ritet efikasiteti i gjykatave administrative dhe përmbushja e drejtësisë administrative.

## **9. Reformat në gjyqësinë administrative në RMV**

Republika e Maqedonis së Veriut, si shtetë i pamvaruar dhe i mvehtësishëm, ka filluar me reformat në ndërtimin e sistemit gjyqësorë funksional dhe efikas i cili do të bazohet në standardet juridike evropiane. Reforma është e parashikuar si mjet themelor për ushtrimin e funksionit gjyqësor, duke aluduar ne qasje të shpejtë tek e drejta, realizim të shpejtë dhe efektiv të drejtave dhe interesave të qytetarëve dhe personave juridik dhe garantim të proceseve për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të qytetarëve, përmes mekanizmave të sistemit gjyqësor.

Segmenti më i rëndësishëm i reformave ishte që të rritet efikasiteti në gjyqësi dhe zvoglimi i lëndëve të pazgjidhura.

Pas pavarimit të Republikës, mbrojtja gjyqësore e procedurave administrative, mbeti në kompetencë të Gjykatës supreme të RM dhe i njëjti vendoste sipas padisë për konfliktet administrative.

---

<sup>51</sup> Në konfliktet administrativeegyistonte mundësia për dënim me të holla sipas nenit 7 të Ligjit për konfliktet administrative i cili bayoheshte ne aplikimin e Ligjit të procedurës kontestimore.

Mirëpo, me Ligjin për gjykatat të vitit 2006 ka filluar reforma në procedurat gjyqësore administrative<sup>52</sup>.

Me themelimin e Gjykatës administrative, e cila filloi me punë më datë 05.12.2007, ja më lëndet e pagjedbura nga fusha administrative, prej Gjykatës supreme të RM.

Së pari, me Ligjin e gjykatave është rregulluar nevoja për formimin e Gjykatës së veçantë administrative, jashta gjyqësive së rregulltë, me kompetencë të veçantë reale, për kontrollën e akteve të nxjera nga organet e administrative në tërë territorin e shtetit.,Pastaj u sollë Ligji për konfliktet administrative<sup>53</sup>, me të cilin është definuar konflikti administrativ si mbrojtje gjyqësore e personave fizikë dhe juridik, persona për shkakë të sigurisë të ligjshmërisë të akteve konkrete administrative.

Gjykata administrative është formua me orjentime që të përcaktojë përmes kontrollit gjyqësorë, se aktet individuale administrative, janë sjellë sipas procedurës së përcaktuar me ligjë, se a janë në pajtueshmëri me fushën adekfate materiale si dhe me vendimit të sigurohet të drejtat dhe obligimet e qytetarëve në procedurë të veçantë.

Me fillimin e punës së Gjykatës administrative, vendimet ishin përfundimtare dhe nuk mundeshte të parashtoheshte mjetë i rregullt juridik, por vetëm mjetet e jashtëzakonshme juridike. Me vendim të Gjykatës kushtetuese, është bërë edhe plotësimi i parë i Ligjit për konfliktet administrative me çka është paraparë dispozita për lejimin e parashtrimit të mjetit të rregullt juridik-ankesa kundër vendimeve të Gjykatës administrative , në kompetencë të vendosjes në Gjykatën e lartë administrative, sipa shembullit të R Sllovenisë<sup>54</sup>.

Në vitim 2011, me Ligjin e gjykatave u formua Gjykata e lartë administrative, sipas shembullit të R Kroacisë<sup>55</sup>, si gjykatë e shkallës së dytë, për ti shqyrtuar ankesat e parashtruara kundrejt vendimeve të Gjykatës administrative, si organ i shkallës së

---

<sup>52</sup> Давитковски, Б., Павловска-Данева, Новини во управно-процесна заштита на правата на граѓаните во Република Македонија, втор скопско-загрпски правен колоквиум, Зборник на трудови, Правен факултет Јустинијан Први, Скопје, 2009

<sup>53</sup> Закон за управните спорови (Службен весник бр.62/06 донесен на 19.05.2006 год. Влегува во сила на 27.05.2006 година, а се применува од 27.05.2007 година)

<sup>54</sup> Kovač.,P., Effective Adjudication through Administrative Appeals in Slovenia, Utrecht Review, Issue 3,2013

<sup>55</sup> Štanišić, F., Britić,V.,Horvat,B., Komentar Zakona o upranim sporovima, Narodne novine DD, Zagreb,2017

parë dhe pjesërisht janë paraparë rregullat procedurale për procedurën e ankimimit me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e LKA, i cili aludonë në Ligjin e procedurës kontestimore.

Deri në fillimin e zbatimit të Ligjit të ri për konfliktet administrative të vitit 2019, kompetenca e Gjykatës supreme ekskluzivisht ishte për vendosjen e ankesave që prashtroheshin ndaj vendimeve të Gjykatës administrative, për mbrojtjen nga veprimet e kundërligjshme si dhe edhe për mjetet e jashtëzakonshme (kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë). Me Ligjin e ri i kufizohen gati se gjitha kompetencat e mëparparëshme, përveç kundrejt vendimeve për konflikte të kompetencave, përndryshe i tërë kontesti administrative kalonë në kompetenca të gjyqësisë administrative.

Përjashtimë nga mbrojtja jurike ende kanë vendimet e Gjykatës administrative, të sjellura në bazë të Kodit zgjedhor<sup>56</sup>. Për përpunimin e Ligjit të ri për KA e në veçanti për reformat në sferën e konflikteve administrative dhe gjyqësisë administrative, rëndësi të veçantë kishte analiza e praktikës, regullativës ligjore dhe eksperiencës së gjyqësisë administrative të Italisë, Austisë, Sllovenisë dhe Kroacisë<sup>57</sup>.

---

<sup>56</sup> Kodi zgjedhorë (Gz. yrtare 40/2006, 36/2008, 148/2008, 155/2008, 63/2008, 4/2011, 51/11, 142/12, 31/2013, 34/2013, 196/2015, 35/2016, 97/2016, 99/2016, 136/2016, 142/2016, 67/2017, 125/2017, 35/2018, 99/2018, 140/2018, 208/2018, 27/2019, 98/2019 dhe 42/2020)

<sup>57</sup> Компаративна анализа на добрите практики за административна пракса во рамки на проект на ЦПИА и ревизорска куќа PriceWaterhouse Coopers финансиски поддржан од Обединетото Кралство

## KAPITULLI - IV

### Studimi empirik:

#### I. Intervistat

Sa i përket studimit empiric, kam aplikuar metodën cilësore, ngase tema kufizohet vetëm me institucionin e konfliktit administrativ dhe gjyqësinë administrative në Republikën e Maqedonisë Veriore, prandaj kam përzgjedhur bartës të funksioneve publike –institucionale me rëndësi, përfshirë këtu, Avokatin e popullit të RMV-së, një gjykatës të Gjykatës së lartë administrative dhe Kryetarin e Gjykatës administrative të RMV-së, një gjykatës të Gjykatës supreme të RMV-së si dhe dy profesorë universitarë të fushës administrative kushtetuese, me të cilët kam zhvilluar intervista gjysmë të strukturuar.

Për shkak të kufizimeve, si rrjedhojë e pandemisë dhe kushteve specifike të gjyqësorit, intervistat janë zhvilluar online, kryesisht përmes emailit, por paraprakisht përmes konsultave fizike dhe marrjes së pëlqimit të tyre dhe parashtrimt të çështjeve intervistuese.

Informatat e gjeneruara nga këto intervista janë inkorporuar në studim.

Çështje intervistuese janë të lidhura ngushtë me gjyqësinë administrative dhe mbrojtjen juridike të drejtave dhe lirive të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë Veriore, edhe atë:

- **Çështja e parë:** *Si e vlerësoni punën e gjyqësisë administrative (Gjykatës administrative dhe Gjykatës së lartë administrative) në funksion të mbrojtjes juridike të të drejtave dhe lirive të qytetarëve në RMV-së ?*
- **Çështja e dytë:** *Si është raporti Juaj me gjykatat administrative, më mirë thënë bashkëpunimi Juaj ?*
- **Çështja e tretë:** *Sa respektohen, vendimet e gjykatave administrative nga organet e administrates publike dhe institucioneve tjera me autorizime publike?*
- **Çështja e katërt:** *A funksionon parimi i meritokracisë, depolitizimit dhe profesionalizmit tek gjykatësit e gjyqësisë administrative ?*

- **Çështja e pestë:** *Sa janë në dijeni qytetarët për gjykatat administrative, në vendin tonë ?*
- **Çështja e gjashtë:** *A mundeni të na siguroni ndonjë të dhënë statistikore (tabelare) për parashtrirat e drejtuara në institucionin Tuaj, në lidhje me procedurat gjyqësore administrative për konfliktet administrative, pranë gjykatave administrative, tre vitet e fundit?*
- **Çështja e shtatë:** *Do të jenë të mirëseardhura edhe këshillat, sugjerimet dhe informatat shtesë të Juaja, në lidhje me çështjen në fjalë.*

## 1. Intervistë: Me Avokatin e Popullit të RMV-së, z.Naser Ziberi

### Çështja e parë:

- *Si e vlerësoni punën e gjyqësisë administrative (Gjykatës administrative dhe Gjykatës së lartë administrative) në funksion të mbrojtjes juridike të drejtave dhe lirive të qytetarëve në RMV-së ?*

Gjykata administrative padyshim paraqet institucionin themelor për zgjidhjen e kontesteve administrative e në këtë funksion – realizimin e të drejtave dhe lirive të qytetrit në raport me organet e administratës. Fatkeqësisht, gjykata administrative aktualisht përballet me dy probleme themelore

1. Kapacitetin e pamjaftueshëm kadrovik si rezultat i të cilit janë edhe vonesat në shqyrtimin e kërkesë-padive, pra gjykimi në afatin e parapar ligjor dhe
2. çështja e dytë, marrja e vendimeve meritorë.

Që të dyja këto çështje ndikojnë drejtëpërsëdrejti në pengimin-prolongimin e realizimit të të drejtave të qytetarëve në raport me organet e administratës si shkëlës potencial të lirive dhe të drejtave të qytetarëve.

Edhe pse me ndryshimet e ligjit për kontestet administrative, Gjykata administrative si gjykatë e shkallës së parë ka autoritetin-kompetencën për sjelljen e vendimit meritor, në të shumtën e rasteve ajo nuk merr vendim meritor, por e kthen lëndën në rishqyrtim pranë organit të administratës, edhe pse ka fakte të mjaftueshme për marrje të vendimit meritor.

### Çështja e dytë:

- *Si është raporti Juaj me gjykatat administrative, më mire thënë bashkëpunimi Juaj ?*

Bashkëpunimi i insitucionit të Avokatit të popullit me gjykatën administrative dhe Gjykatën e lartë administrative është i determinuar me vet natyrën e kompetencës që kanë këto institucione.Pra, mbrojtja e të drejtave të qytetarit në raport me organet e administratës, por, kuptohet gjykatat në sferën e dhënies së drejtësisë ndërsa Avokati I popullit në monitorimin e vendimeve të organeve të administratës dhe organizatave dhe institucioneve tjera publike.

Në këtë kuptim gjykatat bëjnë rivendikim të vendimëve ndërsa Avokati i popullit mbykqyrje të vendimeve të organeve të administratës. Në këtë kuptim këta dy respektivisht tre subjekte janë të thirura të bashkëpunojnë në funksionim të respektimit dhe afirmimit të lirive dhe të drejtave të qytetarëve.

Kuptohet ky është koncepti i sistemit, në praktik situatë ndryshon. Ndodh që gjykata administrative nuk përgjigjet në kërkesat e avokatit të popullit, shpeshherë jepen përgjigje formale që nuk janë të mjaftueshme për nxjerrje të konkluzionit se a ka shkelje apo jo të lirive dhe të drejtave të qytetarëve, zvarritja e përgjigjeve shpeshherë e dëmton kualitetin e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve, e kështu me radhë.

#### **Çështja e tretë:**

- *Sa respektohen vendimet e gjykatave administrative nga organet e administratës publike dhe institucioneve tjera me autorizime publike ?*

Kur vendimi është meritore, ai duhet të ketë fuqi ekzekutive-përmbarese. Pra, ky lloj i vendimit duhet të jetë fjala e fundit, fatkeqësisht në praktik nuk ndodh çdoherë kështu. Kjo sidomos kur vendimet nuk janë meritore, ndodhë që për një çështje të përsëritet procedura gjyqësore disa here.

Por edhe kur gjykata merr vendim meritore, ka raste kur i njëjti nuk respektohet dhe me këtë drejtëpërdrejt shkelet rëndë mbi të drejtat e qytetarëve.

#### **Çështja e katërt:**

- *A funksionon parimi i meritokracisë, depolitizimit dhe profesionalizimit tek gjykatësit e gjyqësisë administrative ?*

-Gjykata administrative nuk përbën përjashtim nga gjendja e përgjithshme si në organet e administratës ashtu edhe në gjyqësor, përfshi edhe gjatën administrative.

Mendoj se pushteti ekzekutiv por edhe ai ligjdhënës kanë ndikim direkt ose indirekt në rekrutimin e kuadrit gjyqësor. Mendoj se këtu bëhet fjalë për imponim dhe ndërtim real të raportit të ndërvarësisë, sepse struktura ligjore parasheh instrumente të mjaftueshme për ndërtim të raportit të pavarësisë dhe kooperimit mbi principe të reciprocitetit.

Pra, gjykata administrative duhet të ndërtohet si autoritet imponues e jo nënshtrues, kuptohet në ushtrimin ligjor të kompetencave të saja.

#### **Çështja e pestë:**

- *Sa janë në dijeni qytetarët për gjykatat administrative në vendin tonë ?*

Për këtë çështje duhet të bëhet ndonjë hulumtim, anketim i cili mund të na sjell në konkluzion të mbështetur në të dhëna. Gjykuar sipas perceptimit tim, mendoj se në qarqet profesionale, por edhe te qytetarët me arsimim akademik ka njohuri, ndërsa te kategoritë tjera jo edhe aq. Kuptohet se për këtë situatë ka shumë arsye, por, gjykimi ad-hoc nuk është se na ndihmon, sepse mundet të jetë subjektiv dhe pa të dhëna të mjaftueshme.

#### **Çështja e gjashtë:**

- *A mundeni të na siguroni ndonjë të dhënë statistikore (tabelare) për parashtrësit Tuaja në lidhje me procedurat gjyqësore administrative për konfliktet administrative, pranë gjykatave administrative, tre vitet e fundit?*

Këto të dhëna do ua përcjell në mënyrë plotësues, edhe atë;

### **1.1 Raportet e punës dhe konstatimet e Avokatit të popullit të RMV me Gjykatën administrative dhe Gjykatën e lartë administrative, për vitin 2020, 2021 dhe deri më 31.05.2022**

#### **a/ Gjykata administrative**

Raporti i parashtrësive të Avokatit të popullit të dërguara në Gjykatën administrative dhe Gjykatën e lartë administrative, për vitet 2020, 2021 dhe përfundimishtë deri më 31.05.2022, për punën e GJA, janë parashtruar gjithësejtë 144 parashtrësia, nga të cilat:

**Në vitin 2020:** 56 parashtrësia ( është ngritur procedura për 33 parashtrësia);

**Në vitin 2021:** 59 parashtrësia ( është ngritur procedura për 29 parashtrësia);

**Përfundimishtë me 31.05.2022:** 29 parashtrësia ( është ngritur procedura për 26 parashtrësia);



**Për lëndët e vitit 2020**, gjer te Gjykata administrative, janë dërguar 45 kërkesa për të mar sqarime, informacione dhe fakte për të dhënat në parashtresat, 8 urgjenca, dhe 2 vërejtje , për mënyrën e shmangëjes të shkeljeve të konstatuara.

**Për 37 kërkesa nga ana e Gjykatës administrative**, janë ndërmarë veprime në afatin e paraparë ligjorë, ndërsa për 8 kërkesa pas kalimit të afatit paraparë gjegjësishtë për urgjencat e dërguara, për çka nga ana e sajë, është vepruar në pajtueshmërijë me 2 vërejtjet e dhënuara prej Avokatit të popullit.

**Për lëndët e vitit 2021**, gjer te Gjykata administrative janë dërguar gjithësejtë 35 kërkesa për të mare sqarime, informata dhe fakte, për të dhënat në parashtresat, 10 urgjenca dhe 2 vërejtje për mënyrën e shmangëjes së shkeljeve të konstatuara.

**Për 22 kërkesa nga Gjykata administrative** janë ndërmarë veprime në afatin e paraparë, ndërsa për 10 pas kalimit të afatit gjegjësishtë për urgjencat e dërguara për çka nga ana e sajë, është vepruar në pajtueshmërijë me përmbajtjen e 2 vërejtjeve të dhëna nga Avokati I popullit.

**Përmbajtja e përgjigjeve të mara prej Gjykatës administrative**, gati se ëdoherë janë të karakterit formal gjegjësishtë se procedura sipas padisë konkrete është në vijimë, se nga organi I shkallës së dytë ose Komisionit shtetërorë, ende nuk janë dërguar padija dhe dokumentet e lëndës, dhe se për momentin ndërmiren veprime të karakterit administrative dhe se në mënyrë plotësuese do të vendoset.

**Duhet theksuar se nga viti 2022**, Gjykata administrative, dërgon përgjigje më të saktë dhe esenciale dhe ate në mënyrën që në përgjigjet për lëndën i thekson të gjitha veprimet nga dita e parashtrimit të padisë ( dërgimin e kërkesës për rregullimin, dërgimin e padisë për përgjigje deri tek i padituri dhe palët e interesuara, ditën e ekspeditimit, të dhënat e dërgesës, përcaktimin e seancës kryesore për lëndën, ditën e ekspeditimit të vendimit të sjellur dhe dokumentet e lëndës, gjer te organi I padtur, etj.) si dhe periudhën e ndërmarje së tyre.

**Vërtje:** Mementalisht të ngelura për punimë janë 10 parashtresa, të cilat janë parashtruara gjat vitit 2022.

## **b/ Gjykata e lartë administrative**

Për vitet 2020, 2021 dhe përfundimisht de ri më 31.05.2021, për punën e GjLA, janë parashtruar gjithësejtë 44 parashtresa, nga të cilat:

**Në vitin 2020:** 21 parashtresa ( është ngritur procedura për 10 parashtresa);

**Në vitin 2021:** 17 parashtresa ( është ngritur procedura për 5 parashtresa);

**Përfundimishtë me 31.05.2021:** 6 parashtresa ( është ngritur procedura për 6 parashtresa);

**Për lëndët e vitit 2020,** deri te Gjykata e lartë administrative, janë dërguar gjithësejt 17 kërkesa për të marre sqarime, informata dhe argumente për të dhënat në parashtresat, 4 urgjenca dhe përsëri 2 urgjenca. Përveç kësaj në periudhën në fjalë deri te Gjykata e lartë administrative janë dërguar edhe 7 kërkesa në kontekst të parashtresave të parashtruara për punën e organeve dhe institucioneve tjera.

Nga Gjykata e lartë administrative, 20 kërkesa janë procesuar në afatin e paraparë, 3 pas afatit, gjegjësishtë pas dërgimit të urgjencave dhe për 1 lëndë procesuimi është bërë pas dy urgjencave të përsëritura.

**Për lëndët e viti 2021,** deri te Gjykata e lartë administrative, janë dërguar 5 lëndë për sqarime, informata dhe argumete në parashtresat të cilat janë procesua në afatin e paraprë nga gjykata.

**Për lëndët e vitit 2022,** deri te Gjykata e lartë administrative, janë dërguar gjithësejt 6 kërkesa për të marre sqarime, informata dhe argumente për të dhënat në parashtresat, për 5 kërkesa janë procesua në afat të paraparë a për 1 pas afatit të paraparë.

**Përmbajta e përgjigjeve nga Gjykata e lartë administrative** më së shpeshti është e karakterit formalë.

**Vërejtje:** momentalishtë përpunohen 2 parashtresa, të cilat janë parashtruar në vijim të viti 2021.

## **2. Konstatimet për gjyqësinë administrative – Raporti i punës për vitin 2020**

- Gjengja e jashtëzakonshme dhe regjimi i veçantë i punës së gjykatave, e pamundësoi zbatimin e Ligjit për konfliktet administrative më saktësishtë ndryshimet në saje të mundësive për mbajtjen e seancave publike e cila u reflektua në efikasitetin e procesuimeve të lëndëve. Si pasojë e së cilës Gjykatat administrative vepronin me vonesë, gjegjësishtë jashtë afateve të parapara ligjore.

- Në raport me ankesat lidhur me punën e gjykatave administrative, Avokati i popullit konstatoi se edhe më tutje për shkak të komunikimit jo të mire të organeve të administratës shtetërore me gjyqësinë administrative, dokumentet e lëndëve nuk dërgohen në kohë për çfarë edhe procedurat stërgjaten, ndërsa gjykatat administrative vazhdojnë me praktikën në vendë që të sjellin vendime meritore, lëndët i kthejnë në rishqyrtimë tek organet administrative vendimet e të cilave ishin të kontestuara.
- Për shkak të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve në procedurat administrative, Avokati i popullit në rastet konkrete, intervenonte në mënyrën e kërimit të të dhënave të jenë në kohë të mbledhura, lëndët të procesuon në kohë nga gjykatat, ndërsa palët në procedurat të jenë në kohë të informuar për të gjitha masat dhe aktivitetet e ndërmara.

## **2.1 Konstatimet për Gjyqësinë administrative – Raporti i punës për vitin 2021**

- Numër i konsiderueshëm i parashtresave të kësaj lëmie, ka të bëjë me punën edhe të gjykatave, për çka edhe pse është miratuar dhe që është në fuqijë Ligji për konfliktet administrative, qytetarët edhe më tutje ankohen për të njejtat problem, gjegjësishtë prolongimi i tepërt i këtyre procedurave, mosmbajtja e seancave publike dhe mosjellja e vendimeve meritore.
- Në bazë të qasjes ndaj lëndëve, Avokati i popullit konstaton se prolongimi i këtyre procedurave është për shkak të mospasjes së komunikimit adekuat në mes organeve të shtetit dhe raporti injorues ndaj kërkesave të Gjykatës administrative për ti dërguar dokumentet e kërkuara, arsyeja e së cilës është stërgjatja e procedurave dhe nxitja e pakënaqësisë tek qytetarët.
- Në këtë segment, aspak nuk është kontestuese se dërgesa dhe ekspedicionimi i aktëgjykimeve dhe aktvendimeve deri te palët dhe Gjykata e lartë administrative, vendos sipas ankesës së vendimit të Gjykatës administrative, bëhet me vonesë edhe me disa muaj vonësë. Gjykata administrative bile edhe

me kërkesë të Avokatit të popullit, nuk dërgon përgjigje në kohë dhe të njejtat nuk i përmbajnë informatat e kërkuara ose janë të natyrës formale.

- Mu për këtë, Avokati i popullit është i detyruar që të ndërmarë veprime me të cilat Gjykatës administrative i tërhiqet vërejtja e nevojës së pashmangëshme për respektimin e kompetencave të Avokatit të popullit, të cilat kontribuojnë gjegjësishtë ekskluzivisht janë në drejtim të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve dhe të gjithë personave tjerë, duke mosë përjashtuar edhe këte gjykatë.

## 2. Intervistë: Me gjykatësin e Gjykatës Supreme të RMV-së, Mr.Faik Arslani

### Çështja e parë:

- *Si e vlersoni punën e gjyqësisë administrative (Gjykatës administrative dhe Gjykatës së lartë administrative) në funksion të mbrojtjes juridike të drejtave dhe lirive të qytetarëve në RMV-së ?*

Sdo mend se gjyqësia administrative në funksion të zgjidhjes së konflikteve administrative në RMV-së, ka një rol dhe rëndësi të veçantë në mbrojtjen juridike të të drejtave dhe lirive të qytetarëve në raparet me organet e administratës publike. Para vitit 2006, konfliktet administrative zgjidheshin në kuadër të Gjykatës supreme si instance e fundit gjyqësore gjë që e vështisonte dhe e stërngarkonte punën e Gjykatës supreme si dhe reflektoheshte një pakënaqsi nga ana e qytetarëve. Me Ligjin e vitit 2006 për konfliktet administrative, me të cilin u krijua Gjykata administrative enkas për konfliktet administrative, jo vetëm që e lehtësoi punën e Gjykatës supreme por edhe riti edhe efikasitetin dhe efektivitetin e zgjidhjes së konflikteve administrative dhe gjithësesi se u rit edhe kënaqshmëria e qytetarëve. Prandaj, vlersimi imë është pozitiv për gjyqësinë administrative. Sa i përket punës së gjyqësisë administrative, sdo mend se çdo fillim i ka vështërsitë e veta si formale edhe material, organizative, mirpo me kalimin e kohës dhe me ndrihimin dhe plotësimin e normativës juridike gjyqësore dhe të konflikteve administrative, cilësia e punës së gjyqësisë administrative është rritur dukshëm.

### Çështja e dytë:

- *Si është raporti Juaj me gjykatat administrative, më mire thënë bashkëpunimi Juaj ?*

Momentalisht raporti i Gjykatës supreme me Gjykatën e lartë administrative, është i përcaktuar në mënyrë ligjore si instancë e tretë gjyqësore në zgjidhjen e konflikteve administrative .Kjo më së miri shihet në neni 39 të Ligjit për ndryshimet dhe plotësimin e Ligjit për konfliktet administrative e vitit 2010, me të cilin parshihet se Prokurori publik i RMV-së, është organ i vetëm i autorizuar i cili mund të parashtrijë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundrejt vendimit të gjykatës i sjellur sipas padisë për përsëritjen e procedurës dhe se Gjykata supreme e RMV-së vendosë në séancë të

përgjithshme për përsëritjen e procedurës. Pra, kompetencat e Gjykatës supreme janë reduktuar shumë në kontekstin e zgjidhjes së konflikteve administrative.

### **3. Intervistë: Me gjykatësin e Gjykatës së Lartë administrative të RMV-së, Dr. Subhi Jakupi**

#### **Çështja e parë:**

- *Si e vlerësoni punën e gjyqësisë administrative (Gjykatës administrative dhe Gjykatës së lartë administrative) në funksion të mbrojtjes juridike të drejtave dhe lirive të qytetarëve në RMV-së ?*

Gjyqësia administrative në RMV përherë të parë nga aspekti legjislativ hapat e para i gjenë me Ligjin për gjykata sjellur më 5 Maj 2006 ku njëheri rregullon që të themelohet Gjykata administrative e cila fillon me punë më 05 Dhjetor 2007, ndryshime të Ligjit për gjykata bëhen në viti 2010 që parashifet themelimi i Gjykatës së lartë administrative, ndërsa kompetencat, përbërja e gjykatës dhe procedurat që vendosin në kontestet administrative dhe përmbarimin e aktgjykimeve gjyqësore të sjellura i rregullon Ligji për kontestet administrative i sjellur më 19.05.2006 ndërsa fillon me implementim më 27.05.2007, ndryshimet e të njejtit bëhen më vitin 2010 ku parashifet që të filloje me punë edhe Gjykata e lartë administrative, ndërsa më 17.05.2019 sillet ligji i ri (Ligji për kontestet administrative) ku fillon me implementim më 25.05.2020.

Gjykatat në fjalë në aspektin organizativ, hapsinor dhe kapaciteteve të resurseve ka hasur në vështirësi në implementimin e kompetencave ligjore por me kalimin e kohës ka përparim në aspektin kualitativ, si të vendimeve gjyqësore ashtu edhe kapaciteteve të burimeve tjera të nevojshme për punë. Me implementimin e Ligjit për konteste administrative që është punuar deri në hyrje të ligjit të ri 2020 u detektuan sëri të ashtuquajtura defekte në implementim të sipër si në stërgjatjeve të procedurave administrative ashtu edhe në mos përmbarimin e vendimeve gjyqësore nga organet administrative. Me fillimin e implementimit të Ligjit për kontestet administrative duke filluar prej 25.05.2020 dukshëm ka përparim në shpejtësimin e procedurave administrative në aspektin afateve ligjore ashtu edhe në përmbarimin e vendimeve gjyqësore nga organet administrative edhe pse jemi në detektim të anomalive të dysa normave nga ligji në fjalë.

### **Çështja e dytë:**

- *Si është raporti i GJA me GjLA, më mirë thënë bashkëpunimi i tyre ?*

Atë që potenciam më lartë që Gjyqësia administrative rregullohet me Ligjin për gjykata dhe Ligjin për konteste administrative ku kjo legjislaturë rregullon kompetencat e gjykatave në fjalë, por nga aspekti praktik mund të themi që raportet e këtyra gjykatave janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën për të pasur efikasitet në implementimin e kompetencave të gjyqsisë administrative që reflekton në mbrojtjen e personave fizik dhe juridik në realizimin e të drejtave të tyre që kanë të bëjnë me punën e organet administrative. Me plotë përgjegjësi mund të themi që vitet e fundit të funksionimit të këtyre gjykatave kemi gjykata që janë azhure të vlersuara nga Këshilli gjyqsor republikan por mendoj se nevojë që ende të përmirsojnë relacionet nga ushtrimi i kontrollit të ndërsjellë, komunikim dhe këshillime të përbashkëta si dhe trajnim të stafit profesional gjyqsor.

### **Çështja e tretë:**

- *Sa respektohen vendimet e gjykatave administrative nga organet e administrates publike dhe institucioneve tjera me autorizime publike ?*

Problematikë në vete ka të bëjë edhe me pyetjen e parashtruar se si dhe sa gjejnë implementim, përfundim dhe përmbarrim vendimet e gjyqsisë administrative që me plot përgjegjësi mund të themi se ka hasur në rezistencë bukur të theksuar nga vetë organet administrative, këtë çështje e ka ndihmuar edhe legjislatura administrative meqë gjyqësia administrative nuk ka pasur të drejtë të vendose me juridiksion të plotë. Me sjelljen e ligjit të ri për kontestet administrative pikërisht kaptina nga ligji përmbarrimi i vendimeve gjyqsore edhe ate neni 87,88,89 dhe 90 kanë të bëjnë pikërisht me përmbarrimin e vendimeve gjyqsore që pritët që në të ardhmën të reflektojë rezultat në të mirë të palëve që janë fitues të kontestit administrativ edhe ate brëda 30 ditëve nga marrja e vendimit gjyqsor administrativ vetë argani ka obligim të veprojnë në realizim, në të kundërtën gjyqi ka të drejtë që të sjellë vendim për penalizim ndaj përgjegjësit të organit administrativ në shumë prej 20% nga paga mujore. Për çështjen në fjalë për implementimin e vendimeve vlejnë të respektohen normat nga Ligji për përmbarrim.



### **Çështja e katërt:**

- *A funksionon parimi i meritokracisë, depolitizimit dhe profesionalizimit tek gjykatësit e gjyqësisë administrative ?*

Sa i përket pyetjes së lartpërmendur e gjitha është e rregulluar me Ligjin për gjykata ku parasheh kriteret për zgjedhjen e gjykatësve në gjyqësinë administrative ku janë kritere bukur të larta që parashifen përvoja e punës nga lëmia përkatëse, ndërsa aktualisht të drejtë për tu zgjedhur si gjykatës në Gjykatën administrative duhet më së paku kandidati të ketë qënë 4 vite gjykatës në gjykatë themelore, ndërsa për kandidat në Gjykatën e lartë administrative duhet qënë më së paku 6 vite pandërprerë gjykatës në Gjykatën administrative ose në ndonjërën nga Gjykatat e apelit. Nga kjo kuptojmë që me këto kritere për tu zgjedhur të ushtruarit detyrën gjykatës në gjyqësinë administrative vjenë në shprehje meritokracia, depolitizimi dhe profesionalizimi me shumë pak përjashtime.

### **Çështja e pestë:**

- *Sa janë në dieni qytetarët për gjykatat administrative, në vendin tonë ?*

Meqë Gjykata administrative në vëndin tonë veç më 15 vitë kryen detyrat nga kompetencat e veta, ndërsa Gjykata e lartë administrative 11 vite kryen detyrat nga kompetencat e saj, mendoj se qytetarët veç më kanë njohuri për funksionimin e gjyqësisë administrative por jo që kanë njohuri se për çfarë të drejte ato mund të realizojnë në gjykatat në fjalë. Prandaj mendoj se ka hapsirë për kampanjë informimi për promovim të çështjes së kompetencave që vendos gjyqësia administrative në realizimin e të drejtave të qytetarëve por edhe personat juridik.

**4. Intervistë: Me Prof. Dr. sc. Jeton SHASIVARI - Profesor Ordinar në lëmin juridike: E drejta kushtetuese dhe Administrative, Universiteti i Evropës Jug-Lindore, Tetovë**

**Çështja e parë:**

- *Si e vlerësoni punën e gjyqësisë administrative (Gjykatës administrative dhe Gjykatës së lartë administrative) në funksion të mbrojtjes juridike të drejtave dhe lirive të qytetarëve në RMV-së ?*

Në statistikat e mbajtura nga Gjykata Administrative dhe ajo e Lartë Administrative nuk ka asnjë metodologji dhe rrjedhimisht të dhëna për përqindjen e vendimeve gjyqësore të ekzekutuara, si të Gjykatës Administrative ashtu edhe të Gjykatës së Lartë Administrative. Kjo mangësi krijon një gjendje të pamundësisë për të parë pasqyrën e plotë të efikasitetit dhe veçanërisht efektivitetit të punës së gjykatave administrative në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në këtë mënyrë shkallën e përmbushjes së drejtësisë administrative.

Gjyqësori administrativ është jofunksional dhe nuk arrin të jetë garantues për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe sundimin e ligjit. Vazhdon komunikimi i dobët i organeve të administratës shtetërore me gjyqësorin administrativ, shkresat nuk dorëzohen në kohë, për çka procedurat janë të gjata dhe mbrojtja e të drejtave të qytetarëve para gjykatave administrative është joefektive. E pandryshuar mbetet gjendja sa i përket vendimmarrjes meritore në kontestet administrative nga gjykatat administrative, me çka lëndët në mënyrë të përsëritur kthehen për rivendosje pranë organeve administrative, vendimet e të cilave kontestohen, dhe këto procedura zgjasin me vite apo edhe dekada.

**5. Intervistë: Me Prof. Dr. sc. Blerton Sinani - Profesor inordinar në lëmin juridike: E drejta kushtetuese dhe Administrative, Universiteti i Evropës Jug-Lindore, Tetovë**

**Çështja e parë:**

- *Si e vlerësoni punën e gjyqësisë administrative (Gjykatës administrative dhe Gjykatës së lartë administrative) në funksion të mbrojtjes juridike të drejtave dhe lirive të qytetarëve në RMV-së si dhe sa respektohen, vendimet e gjykatave administrative nga organet e administratës publike dhe institucioneve tjera me autorizime publike ?*

Gjyqësori administrativ në RMV nuk perceptohet si mjaft efikas për shkak të kohëzgjatjes “së theksuar” të mbrojtjes procedurale gjyqësore-administrative si pasojë e pasivitetit të organeve publike për t’i deposituar shkresat zyrtare të një lënde juridike-administrative të caktuar në përputhje me afatet kohore të caktuara nga vetë gjyqësori administrativ dhe t’i zbatojnë me konsekuencë (përpikshmëri) dhe efektivisht vendimet gjyqësore të tij në praktikë. Në fakt, në vitin 2019, në përputhje me ambiciet apo synimet e RMV-së për integritet evropian dhe procesin e harmonizimit juridik të legjislacionit nacional të RMV-së me Unionin Evropian, përkatësisht me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës, që i referohet të drejtës për procedurë të drejtë gjyqësore dhe në afat kohor të arsyeshëm u miratua Ligji i ri për konfliktet administrative.

Me Ligjin për konfliktet administrative të vitit 2019 është parashikuar gjyqësori administrativ të vendos sipas juridiksionit të plotë in meritum (që krahas ushtrimit të kontrollit dhe vlerësimit të ligjshmërisë të aktit juridik administrativ individual përfundimtar vet të vendos mbi esencën e çështjes kontestimore juridike-administrative me vendim gjyqësor); dhe të caktojë sanksione për organet publike që nuk i deponojnë në përputhje me afatin kohor të caktuar nga gjyqësori administrativ shkresat zyrtare të lëndës juridiko-administrative, pra për kërkesëpadinë administrative për të cilën duhet të vendos në konfliktin administrativ gjyqësori administrativ dhe që nuk i ekzekutojnë vendimet gjyqësore të formës së prerë (të plotëfuqishme) dhe që nuk mbajnë shqyrtime publike në konfliktin administrativ si një procedurë gjyqësore-administrative e caktuar me ligj. Këto janë pohime normative të Ligjit për konfliktet administrative të RMV-së të vitit 2019, por në praktikë, realisht dhe faktikisht, ka devijacione apo shmangie nga pohimet normative ligjore përkatëse. Kjo do të thotë se

midis Ligjit për konflikte administrative të RMV-së të vitit 2019 dhe praktikës, haset ekzistenca e diskrepancës (mospërputhjes) midis normatives (kërkesave të ligjit përkatës) dhe reales (asaj që ndodh në praktikë). Kështu, në mbështetje të raporteve të punës dhe të dhënat statistikore të gjyqësorit administrativ të RMV-së, por edhe të raporteve të punës së Ombudspersonit (Avokatit të Popullit) të RMV-së lidhur me veprimtarinë e gjyqësorit administrativ si konkluzione parimore mund të nxirren si vijon:

- ekzistenca e një numri relativisht të vogël të vendimmarrjes sipas juridiksionit të plotë in meritum nga gjyqësori administrativ, edhe pse afirmohet dhe insistohet nga Ligji për konfliktet administrative të vitit 2019 aplikimi i juridiksionit të plotë in meritum nga gjyqësori administrativ, në mënyrë që të bëhet e mundur dhe sigurohet efikasiteti i veprimtarisë së gjyqësorit administrativ në procedurën gjyqësore-administrative, nga kënvështimi i vendimarrjes apo zgjidhjes së çështjeve kontestimore juridike-administrative, por njëkohësisht edhe mbrojtja juridike adekuate dhe realizimi kualitativ dhe efektiv i të drejtave dhe interesave juridike të subjekteve të së drejtës në praktikë;
- organet publike në një masë të konsiderueshme nuk zbatojnë afatet kohore të caktuara nga gjyqësori administrativ për dorëzimin e shkresave zyrtare të lëndës juridiko-administrative që janë në funksion të verifikimit të drejtë dhe të rregullt të gjendjes reale-faktike nga gjyqësori administrativ me qëllim të vendimmarrjes objektive dhe valide nga aspekti i ligjshmërisë lidhur me konfliktin administrativ dhe kjo reflekton impakt negativ në kuptimin e prolongimit kohor të procedurës gjyqësore-administrative në disfavor të realizimit të të drejtave dhe interesave juridike të shtetasve në praktikë nga sfera juridiko-administrative;
- është evidentuar në një numër të caktuar rastesh anashkalimi apo bishtërimi i detyrimit ligjor nga gjyqësori administrativ për mbajtjen e shqyrtimeve publike në konfliktin administrativ si një procedurë gjyqësore-administrative e caktuar me ligj, me ç'rast çenohet parimi juridik i kontradiktorialitetit audiatur et altera pars;
- janë të indentifikuara raste ku sfidohet, përkatësisht ku nuk bëhet ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të caktuara të gjyqësorit administrativ nga organet publike të caktuara.

#### ***Çështja e dytë:***

- *A funksiononë parimi i meritokracisë, depolitizimit dhe profesionalizimit tek gjykatësit e gjyqësisë administrative ?*

Punësimet në sektorin publik, e sidomos në sferën e organeve shtetërore të judikaturës, përkatësisht të gjyqësorit të mbështetur në sistemin e meritokracisë (merit system) që lidhet me rekrutimin për të selektuar kandidatin më të kualifikuar për një pozicion apo vend të caktuar pune në bazë meritore - aftësisë, cilësisë dhe profesionizmit në sektorin publik, përfshirë edhe në gjyqësorin administrativ përbëjnë një element esencial të sundimit të së drejtës dhe të një demokracie funksionale, por njëkohësisht është një mjet i rëndësishëm për zhvillimin e kapaciteteve profesionale të vet gjyqësorit administrativ të RMV-së si një shtet kandidat për integrimin e tij në Unionin Evropian.

Në lidhje me gjyqtarët e gjyqësorit administrativ duke iu referuar raporteve të instancave relevante evropiane e ndërkombëtare lidhur me gjendjen e gjyqësorit në RMV, sado që ka shënuar një progres të caktuar gjyqësori në RMV, por, në një mënyrë ose tjetër praktika tregon dhe dëshmon se në përgjithësi nuk është immune ndaj influencave apo ndikimeve partiako-politike gjatë përzgjedhjes së kandidatëve “preferencial” për gjyqtar në gjyqësorin e RMV-së, përfshirë edhe gjyqtarët e gjyqësorit administrativ nga Këshilli Gjyqësor i RMV-së. Megjithatë, suksesi dhe përgjegjësia juridike për veprimtarinë profesionale të gjyqtarëve të gjyqësorit administrativ është individuale. Rrjedhimisht, mund të pohohet se në kuadër të gjyqësorit administrativ të RMV-së ka gjyqtar të caktuar të dalluar e kualitativ në kuptimin profesional. Prandaj, mund të thuhet se brenda kornizave të gjyqësorit administrativ në RMV në një shkallë të caktuar funksionon meritokracia.

## Përfundimi

Nevoja ditore dhe pjesëmarrja e qytetarëve në procedurat administrative nënkupton që sistemi i sundimit të ligjit varet nga zbatimi i drejtë i ligjeve në praktikë. Gjykata Administrative paraqitet si garant dhe mbrojtës i të drejtave dhe lirive të qytetarëve kundër veprimeve të paligjshme të organeve shtetërore, dhe ajo duhet të sigurojë mbrojtje gjyqësore efikase, efektive dhe ekonomike. Megjithatë, qytetarët e RMV-së kanë vështësi në ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre nga veprimet e paligjshme të administratës shtetërore, kryesisht për shkak të mungesës së mundësive për t'u dëgjuar gjat procedurës në rast të kontestit administrativ.

Hapja e gjykatave, e shprehur përmes shqyrtimeve publike, si dhe shpallja publike e vendimeve, janë segment thelbësor i së drejtës për gjykim të drejtë dhe i sundimit të ligjit. Nga praktika e tanishme e gjykatave administrative mund të konstatohet se shqyrtimi publik me palët në një kontest administrativ është mbajtur vetëm si përjashtim. Nga ana tjetër, standardet evropiane, duke përfshirë edhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), Gjykatësë së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GjDBE) dhe *acquis Communautaire*, theksojnë se natyra publike e procedurave gjyqësore është një nga parimet themelore të së drejtës për gjykim të drejtë.

Në angazhimet e saja për ta reformuar gjyqësinë, Ministria e Drejtësisë parashikon miratimin e një ligji të ri për kontestet administrative (LKA), i cili përcakton se Gjykata Administrative do të marrë vendim vetëm në bazë të shqyrtimit publik, të drejtpërdrejtë dhe me gojë. Me këtë risi ligjore, mbrojtja administrative për qytetarët do të ngrihet në një nivel më të lartë, në përputhje me parimet ligjore. Në mënyrë që të ketë zbatim konsekuent të ligjit, duke pasur parasysh se gjyqtarët administrativ nuk kanë vepruar në shqyrtime publike para palëve, ata kanë nevojë për avancimin e aftësive të tyre për mbajtjen e shqyrtimeve publike në mënyrë që qytetarët të fitojnë një mekanizëm adekuat korrigjues kur pushteti ekzekutiv vepron në kundërshtim me ligjin.

Duke u nisur nga locimi i dobësive paraprake të Ligjit për konfliktet administrative të vitit 2006 i ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2010, u imponua nevoja për Ligjë të

rijë për konfliktet administrative<sup>58</sup>, i cili ishte pjesë e Strategjisë për reforma në sistemin gjyqësorë të periudhës kohore 2017-2022. Ligji u miratua në maj të vitit 2019<sup>59</sup>, me prolongimë të zbatimit për një vitë pas shpalljes, megjithëate në këtë periudhë njëvjeçare nuk u përgaditë as plani implementues i ligjit, as që u siguruan parakushte themelore teknike, që të mundeshte Gjykata administrative të fillojë me punë sipas ligjit të rijë. Me qëllim që të ritet efikasiteti i mbrojtjes gjyqësore në konfliktin administrativ, është më se e domosdoshme krijimi i kushteve teknike dhe hapsinore të gjykatës, për ti mbajtur seancat gjyqësore komfortë risive ligjore. Aqë ma tepër punët u vështirsuan edhe me praqitjen e pandemisë (Kovid 19), e cila imponoi protokole sigurie e veçanarishtë në hapsira të mbyllura në të gjitha gjykatat në përgjithësi.

Për impaktin e zbatimit të Ligjit të rijë për konfliktet administrative, është e nevojshme më së paku një vitë që të mundë të zbatohet ligji. Ligji i rijë për KA filloi me zbatimin e tijë me 25. Maj të vitit 2020, icili në funksionimin e tijë, dukshëm dha kontributë në sigurimin e efikasitetit të mbrojtjes gjyqësore të qytetarëve dhe personave juridikë në konfliktin administrativ.

“Drejtësia administrative sipas rregullave evropiane” është projekt që implementohet nga Qendra për Hulumtime dhe Analiza Juridike, dhe që synon ta përmirësojë sistemin e qeverisjes së mirë në Republikën e Maqedonisë së Veriut duke siguruar një drejtësi efektive administrative të bazuar në standardet evropiane. Projekti do ta rrisë respektimin e parimit të qeverisjes së mirë duke i forcuar kapacitetet e gjyqtarëve administrativ për të mbajtur shqyrtime publike në konteste administrative, sepse ata vetë nuk kanë njohuri për mbajtjen e shqyrtimeve publike në kontestet administrative.

---

<sup>58</sup> Предлог законот е од работна група во Министерство за правда, март 2018 г., во состав професори по управно право, претставници на академската заедница, судии - Врховен, Виши и Управен суд со учество на ССРМ, МИОА, адвокати, Државниот управен инспекторат и од Министерството за правда.

<sup>59</sup> Член 93 од Законот за управните спорови (Сл. весник на РСМ бр.96/19 од 17.05.2019 година

## **Konkluzionet:**

- Nga elaborimi në punimë, mund të konstatojmë se me Ligjin e konflikteve administrative të miratuar në maj të vitit 2019 , i cili filloi të zbatohet prej muajit maj të vitit 2020, është bërë përpjekje serioze për sigurimin e efikasitetit, efektivitetit dhe mbrojtjes gjyqësore kvalitative.
- Veçanërisht në pjesën e cila ka të bëjë me zbatueshmërinë të vendimeve gjyqësore, bëhet edhe harmonizimi i legjislacionit të vendit me rekomandimet dhe standardet evropiane në kuadër të procedurës gjyqësore administrative, me çka detyrueshmëria e vendimeve gjyqësore është përcaktuar si njëri ndër parimet themelore në konfliktin administrativ, ndërsa për mos zbatimin e aktgjykimeve, parashifet edhe shqiptimi i dënimit me të holla për personin përgjegjës gjegjësisht të autorizuar, në lartësi prej 20% të rogës mesatare të atij personi
- Qëllimi i një zgjidhjeje të tillë është respektimi i autoritetit të gjyqit dhe vullnetit të shprehur në vendimet, të cilët u dedikohen situatave konkrete, me çka sigurohet ligjëshmëria në veprimtarinë e organeve publike.
- Gjithëashtu, me këtë risi pritet të tejkalohen parregullsitë e deritanishme në aspektin e zbatimit të vendimeve gjyqësore dhe të zvogëlohet numri i rasteve të moszbatimit të aktgjykimeve apo mos respektimin e udhëzimeve të dhëna në aktgjykime.
- Gjithësesi se, anticipimi i standardeve dhe principeve evropiane në gjyqësinë administrative, pritet të kontribojë në forcimin e sigurisë juridike dhe forcimin e besueshmërisë së publikut se gjyqësia administrative është korektorë kryesorë në funksion të kontrollit të ligjshmërisë së akteve dhe punës së organeve publike.
- Duhet theksuar se, moszbatimi i aktgjykimeve gjyqësore, konsiderohet si anashkalimë i autorizimeve nga ana e organeve me autorizime publike, gjegjësisht personat e autorizuar të cilët ushtrojnë punë administrative dhe ndërmarin veprime administrative.
- Nga kjo, mund të konstatojmë se përveç shqiptimit të dënimit me të holla për moszbatimin e aktgjykimit, do të duhet edhe për vendosjen e dëmshpërblimit, i shkaktuar si rezultat i mos zmatimit të aktgjykimit, si dhe kjo të jetë si



kushtë për përgjegjësi disiplinore dhe materiale të personit të autorizuar, për mos zbatimin e aktëgjyqimit.

## **Rekomandimet:**

- Në të ardhmen, duhet të kihet kujdesë në krijimtarinë e kësajë zgjidhje ligjore, pra zbatimit obligativë dhe ndëshkues të akteve gjyqësore.
- Duhet të ndermiren masa për ndjekjen e realizimit praktikë të zbatimit të kësajë risije ligjore, me qëllimë që të konstatohen implikime të caktuara pozitive dhe negative, nga aplikimi i sajë gjegjësishtë a është rregullativa juridike e mirë apo praktika imponon se egzistonë nevoja për plotësimin dhe precizimin, të cilët rezultate hetohen në praktikë, a ritet apo zvogëlohet numri i lëndëve për zbatimin e akteve gjyqësore.
- Praktika gjyqësore, duhet të përkujdeset për zbatimin adekfatë për zgjidhjet e reja ligjore, e cila parasëgjithash mvaret edhe prej kapaciteteve njerëzore, teknike dhe finansiare në gjykatat administrative.
- Njihkohësishtë, Gjykata administrative do të ballafaqohet edhe me sfidat të cilat kanë të bëjnë në vendosjen e konfliktit administrativë të juriksionit të plotë dhe mbajtjen e seancave shqyrtuese, për çka gjithësesi duhet ti forcojë kapacitetet e saja.
- Organet publike gjegjësishtë personat zyrtarë të autorizuar, ta respektojnë autoritetin e gjyqit dhe me përpiknijë ta zbatojnë dispozitivin e aktëgjykimit në afatin e paraparë ligjorë.

## Bibliografia

1. Zemri Elezi, Kontrolli i administrates-Ligjerata te autorizuarra, 2017/18/19, UEJL,Tetov
2. Agur Sokoli, "Kontrolli i punes se administrates dhe pergjegjesia e saj politike", Prishtine.Prof. dr. Kadri Kryeziu, "E drejta administrative", Prizren, 2019
3. E. Stavileci & A. Sokoli & M. Batalli, “ *E drejta administrative: administrate, kontrolli, pergjegjësia dhe kompjuterizimi i saj*”, Prishtinë, 2010.
4. E. Stavileci & A.Sokoli & M. Batalli, “ *E drejta administrative*”, Prishtinë, 2010.
5. Ermir Dobjani, “*E drejta administrative I*”, Tiranë, 2007
6. E.Stavileci & M.Batalli & S.Sadushi, “ *E drejta administrative: organizimi dhe veprimtaria administrative*”, Prishtinë, 2012
7. Esat Stavileci, “*Nocioni dhe parimet e administratës publike*”, Prishtinë, 2005.
8. Esat Stavileci, “*Administrata në shoqërinë vetëqeverisëse*”, Prishtinë, 1985
9. Esat Stavileci, “*Hyrje në shkencat administrative*”, Prishtinë, 1997
10. Esat Stavileci, “*Nocione dhe parime të administratës publike*”, Prishtinë, 2007.
11. Fejzulla Berisha, “*E drejtë administrative*”, (pjesa materiale), Pejë, 2013
12. Prof.Ass.Dr.Fejzulla BERISHA-Doc.Dr.Jusuf ZEJNELI-E drejta administrative,Peje-2015

13. Nertila Brahimaj-punim I mbrojtur ne Dhjetor 2014, UNHZ-Peje
14. Ivo Borkovic: Upravno Pravo, Zagreb 1997
15. Štanišić, F., Britić, V., Horvat, B., Komentar Zakona o upranim sporovima, Narodne novine DD, Zagreb, 2017
16. Dr. M. Dimitrijević: Uvod u pravu, façe 225, Beograd 1986
17. Sokol Sadushi, "E drejta administrative 2", Tirane.
18. Sokol Sadushi, "Teoria e aktit administrativ", Tirane.
19. С. Гелевски, Управно процесно право, Скопје, 2003;
20. Н. Гризо, С. Гелевски, Б. Давитковски, А. Павловска-Данева, „Административно право“, Скопје, 2008, стр. 244;
21. Давитковски, Б., Павловска-Данева, А. (2006). Новата управно судска контрола над управата во РМ, Зборник на трудови на Правниот факултет, Скопје,
22. Насковска., Е., Казненоправни аспекти на злоупотреба на власта во Република Македонија, докторска дисертација, Правен факултет Јустинијан Први, Скопје, 2019
23. Давитковски, Б., Павловска-Данева, Новини во управно-процесна заштита на правата на граѓаните во Република Македонија, втор скопско-загпрски правен колоквиум, Зборник на трудови, Правен факултет Јустинијан Први, Скопје, 2009
24. Kovač., P., Effective Adjudication through Administrative Appeals in Slovenia, Utrecht Review, Issue 3, 2013;
25. Štanišić, F., Britić, V., Horvat, B., Komentar Zakona o upranim sporovima, Narodne novine DD, Zagreb, 2017;

- **Korniza normative**

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (Gazeta zyrtare nr. 52/1991, 91/2001, 84/2003,107/2005, 3/2009 dhe 49/2011);

- Ligji për gjykatat („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/2006,35/2008 dhe 150/2010); 31/1998, 58/2006;

- Ligji për kontestet administrative („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/2006 dhe 150/2010);

- Ligji për procedurë të përgjithshme administrative („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.124/2015);

- Ligji për Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 60/2006, 69/2006,150/2010,100/2011, 20/2015 dhe 61/2015);

- Ligji për Akademinë për gjykatës dhe prokurorë publik („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.20/2015,192/2015 dhe 231/2015);

- Ligji për zbatimin e vendimeve të GJEDN („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.67/2009 dhe 43/2014);